



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 700/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.11.2019 shqyrtoi ankesat me:

Objekt: “Shfuqizimi i vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e shoqërisë “O.E.S Distrimed” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-17552-04-11-2019, me objekt: “Blerje Autonalizator Biokimik”, me fond limit 3 000 000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 16.05.2019 nga autoriteti kontraktor Qendra Shëndetësore e Specialiteteve nr. 1.”

Ankimues: “Biomedica Albania Distribution” sh.p.k
Rr. “E.Mano”, P.Krigrer, Farke, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Qendra Shëndetësore e Specialiteteve nr. 1
Rr. “Vllazën Huta”, Tiranë

Subjekte tw Interesuara: “O.E.S. Distrimed” sh.p.k
Blv. “Bajram Curri”, Rr. “Nikollë Kaçorri”, ND.1, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.04.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit me Nr.REF-17552-04-11-2019, me objekt: “*Blerje Autonalizator Biokimik*”, me fond limit 3 000 000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 16.05.2019 nga autoriteti kontraktor Qendra Shendetësore e Specialiteteve nr. 1.

II.2. Në datën 21.05.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë njoftuar elektronikisht nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi klasifikimin e ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si vijon:

1. “O.E.S. Distrimed” sh.p.k	1.298.750 lekë, skualifikuar
2. “Fedos” sh.p.k	1.570.000 lekë, skualifikuar
3. “Genius” sh.p.k	1.980.000 lekë, kualifikuar
4. “Farma Net Albania” sh.p.k	2.850.000 lekë, skualifikuar
5. “Biomedica Albania Distribution ” sh.p.k	2.935.000 lekë, kualifikuar
6. “Krijon” sh.p.k	ska paraqitur ofertë

Shoqëria “O.E.S. Distrimed” sh.p.k rezulton i skualifikuar nga KVO-ja me argumentin:

“Operatori ekonomik nuk i ka te gjitha specififikimet teknike dhe kriteret e pergjithshme te parashikuara ne DST.

Nuk i ploteson specififikimet teknike sipas DST

Oferte anomalisht e ulet.”

Shoqëria “Fedos” sh.p.k rezulton i skualifikuar nga KVO-ja me argumentin:

“Operatori ekonomik nuk i ka te gjitha specifikimet teknike dhe kriteret e pergjithshme sipas DST.”

II.3. Në datën 27.05.2019 operatori ekonomik “O.E.S. Distrimed” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij nga procedura e mësipërme e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“[...]Në njoftimin tuaj për skualifikim shpreheni se operatori ekonomik nuk plotëson specifikimet teknike dhe kriteret e përgjithshme të pranimit. Lidhur me këtë cilësim konstatojmë së pari se ju nuk shpreheni specifikisht cilat specifikime nuk përmbush oferta jonë dhe cilat prej kriterëve të përgjithshme nuk plotëson dokumentacioni i paraqitur në tender nga operatori ynë ekonomik [...].”

II.3.1. Nëpërmjet shkresës nr. 584/2 prot., datë 03.06.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje shoqërisë “O.E.S. Distrimed” sh.p.k, si më poshtë:

“[...]”

1. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i jep të drejtë kompanisë “OES Distrimed” sh.p.k në lidhje me mungesën e shprehjes në mënyrë specifike nga ana e KVO për specifikimet teknike të paplotësuara nga OE. Për këtë arsye rekomandon rrëzimin e vendimit për mosrespektim të procedurës nga ana e KVO.

2. Në lidhje me skualifikimin e ofertës suaj si anomalisht e ulët konstatojmë se KVO nuk ka respektuar procedurën e nevojshme për ti kërkuar OE që të paraqesë me shkrim brenda 3 ditëve, shpjegimet e nevojshme në lidhje me elementët e vecantë të ofertës. Gjithashtu në mbështetje të nenit 56 të LPP-së Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave verifikoi nëse oferta është anomalisht e ulët, u llogarit formula për ofertë anomalisht të ulët nga ku rezultoi se oferta e “O.E.S. Distrimed” sh.p.k është anomalisht e ulët. Gjithashtu KSHA shqyrtoi dhe argumentin tuaj në lidhje me ofertën për tenderin me objekt “Blerje autoanalizator biokimik”, e protokolluar nga ana jonë me nr. 577 prot., datë 01.06.2019. Informacioni i paraqitur nga kompania juaj nuk e bindi KSHA që pajisja me objekt autoanalizator biokimit mund t’i plotësojë nevojat e institucionit tonë. Gjithashtu kompania që ju ka dërguar përgjigjen, nuk korrespondon të jetë e përkthyer në gjuhën shqipe të kërkuar sipas DST.

3. KSHA shqyrtoi të gjithë dokumentacionin dhe konstatoi që ka mungesë konkretisht në pikat:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikaten CE Full Quality Assurance System të prodhuesit sipas Direktivave 93/42/EEC dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, të prodhuesit, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave. Certifikata duhet nga organet certifikuese ndërkombetare dhe të jete per secilin artikull specifik të ofruar në kete procedure prokurimi.

Pra, kompania juaj ka paraqitur një certifikatë sipas direktivave 98/79 EEC e jo sipas direktivave 93/42/EEC të kërkuara nga ana jonë.

2.3.6. Kopje të vertetuar nga Organet Tatimore të List Pageses së Sigurimeve Shoqërore të gjeneruar nga sistemi elektronik i tatimeve sipas formularit ESIG025 ku të perfshihen dhe emri i Inxhinierit, per periudhen Shkurt 2018- Shkurt 2019.

KSHA konstatoi se kompania juaj ka paraqitur formularët ESIG025 ku inxhinieri është i përfshirë por asnjë nga këto formularë nuk është i vërtetuar nga Zyrat Tatimore me vulë dhe firmë të njomë ose me anë të vulës elektronike të gjeneruara nga tatimet.

Për këtë arsye e konsiderojmë këtë kriter të pa përmbushur nga kompania juaj sipas DST dhe kritereve të kërkuara.

Gjatë periudhës së ankimimit ka një ankesë drejtuar ofertës suaj nga operatorë të tjerë ekonomikë me interes të drejtpërdrejtë për këtë procedurë për të rishikuar dhe investiguar mbi kontratat tuaja të ngjashme dhe konkretisht kapacitetet teknike pika 2.3.1.

Nga konstatimet tona në dokumentacionin e tenderit gjendet:

- Një kontratë “Blerje pajisje mjekësore dhe mobilimi për QSH Kamëz datë 18.04.2017 në vlerën 9.754.400 me faturë tatimore datë 10/5/2019 nr.225930307.*
- Datë 1/8/2018 cell counter General Farma ft 225933799 në 495.500 pa tvsh.*
- 31/05/2018 ft nr 225933296 centrifug 390 euro pa tvsh.*
- Fat datë 31/10/2017 Genalb Farma nr 225931578 në vlerën 555.000 pa tvsh.*
- Datë 3/10/2018 fat nr22593254 Coagulometer 1000 euro pa tvsh.*

Kontrata “Blerje pajisje mjekësore dhe mobilimi për QSH Kamëz” datë 18.04.2017 në vlerën 9.754.400 nuk përmbush kriterin për dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme, duke qënë se Aparat Grafie, EkoKardiale dhe Gjinekologjike për laboratorin etj., janë pajisje pa ngjashmëri me autoanalizator biokimik për laboratorin e institucionit tonë.

Faturat e paraqitura për Cell Counter, Pipeta, Mikser Rroller, Fotometer, Analizator urine, Centrifugat dhe Coagulometer nuk konsiderohen si dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme me autoanalizator biokimik.

Për këtë arsye, pretendimi i ngritur kundër kompanisë tuaj për mospërmbushje të kapacitetit teknik, pika 2.3.1 qëndron dhe është i drejtë. Ky kriter është i pa përmbushur nga kompania sipas DST.

4. KSHA gjithashtu shqyrtoi dhe dokumentacionin e specifikimeve teknike ku vuri re mungesë në pikat:

3.1 Disku të përmbajë jo më pak se 50 tuba analizash.

KSHA konstatoi që sipas katalogut të dorëzuar nga ana juaj, disku përmbante 40 tuba analizash dhe 50 tuba sipas specifikimit teknik të kërkuar nga ana jonë.

2.5 Leximi i absorvancës nuk fillon nga 0.0

4.4 Metoda e analizës endpoint, kinetike. Fixed-time, monokromatike/biokromatike, reagentkimike single/dual, turbidmetry, teknologji zgjedhës të elektrodës së joneve, fotometri absorbuese.

KSHA konstatoi se kjo e dhënë nuk paraqitej në katalogun origjinal të kompanisë tuaj.

5.3 Të ketë 40 kyeveta shumëpërdorimshe.

Katalogu i dorëzuar nga kompania juaj e përmbante nr e kyevetave por jo shumëpërdorimshe.

5. Gjatë periudhës së ankimimit ka ardhur një ankesë drejtuar ofertës tuaj nga operatorë të tjerë ekonomikë me interes të drejtpërdrejtë për këtë procedurë për të rishikuar dhe investiguar mbi

mosplotësimin e kriterit 7.3 ku kërkohet që kompania të ketë staf të trajnuar për pajisjen e cili është objekt prokurimi, të shoqëruar me certifikatë.

KSHA konstatoi se në dokumentat e dorëzuara nga kompania OES Distrimed sh.p.k ekziston si më poshtë:

- *Kontrata me inxhinierin A.Prendi, CV dhe diploma plotësojnë kriteret e tenderit.*
- *Gjithashtu kompania ka paraqitur një certifikatë pjesëmarrje nga data 27/11/2018 deri në datën 28/11/2019 në kursin Biochemistry Analyzer BS-240, të lëshuar nga kompania Mindray.*

Certifikata e pjesëmarrjes nuk është certifikatë trajnimi për suportin dhe mirëmbajtjen e pajisjes. Për këtë arsye e konsiderojmë këtë kriter të papërbushur nga kompania juaj.”

II.3.2. Në datën 11.06.2019, pala ankimuese “O.E.S Distrimed” sh.p.k, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar si më poshtë vijon:

“Në datën 21.05.2019 është publikuar vlerësimi i ofertave ku oferta jonë skualifikohet me arsyet e mëposhtme:

“Operatori ekonomik nuk i ka të gjitha specifikimet teknike dhe kriteret e përgjithshme të parashikuara në DST.

Nuk i plotëson specifikimet teknike sipas DST

Oferte anomalisht e ulët.”

Duke qënë se arsyet e skualifikimit janë anti ligjore dhe të pabazuara në fakte dhe duke mos dhënë arsyet e vërteta të skualifikimit, në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik, ne iu drejtuam me ankesë AK, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit dhe duke dhënë një pasqyrë mbi plotësimet e kriterëve dhe të specifikimeve teknike.

Me datë 30.05.2019 kemi marrë shkresë nga AK me nr. 568 prot., ku AK konfirmon se ka marrë në shqyrtim ankesën tonë dhe kërkon shpjegime për ofertën anomalisht të ulët. Kjo shkresë është në kundërshtim me nenin 78 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, pika 6 (a) ku citohet “... Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të ketë marrë pjesë në marrjen e vendimit për të cilin është paraqitur ankesa”, pasi shkresa është firmosur nga Znj. E.Çitozi në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Pavarësisht këtij fakti, ne i kemi kthyer përgjigje AK me shkresën nr.51 prot., datë 31.05.2019 duke argumentuar ofertën tonë në të gjithë elementët e saj.

Me datë 03.06.2019 AK ka kthyer përgjigje përmes shkresës nr. 580 prot., datë 03.06.2019 me objekt: “Vendim lidhur me ankesën tuaj për prokurimin me objekt Blerje Autoanalizator biokimik me vlerë 3 000 000 lekë pa tvsh”.

Fillimisht duam të kundërshtojmë këtë vendim në tërësinë e tij pasi është në kundërshtim të plotë me nenin 78 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, pika 6 (a) ku citohet “Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës... Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të ketë marrë pjesë në marrjen e vendimit për të cilin është paraqitur ankesa”. Nga informacionet që kemi asnjëri nga anëtarët e KSHA nuk është ekspert i fushës pasi objekti i prokurimit është Blerje autoanalizator biokimik, e cila është një pajisje laboratorike ndërsa anëtarët e KSHA janë me profesione shefe finance, mjek imazheri-Echo

dhe mjeke gastrologer. Gjithashtu në kundërshtim të hapur me ligjin, AK ka vendosur në KSHA të njëjtin anëtar znj.E.Çitozi i cili ka qënë njëkohësisht kryetar i KVO-së.

AK në vendimin e tij nr. 580 prot., datë 03.06.2019 ka renditur arsye skualifikimi për të cilat nuk jemi vënë në dijeni më përpara në mënyrë që të kishim mundësi t'i ankimonim pranë AK, duke na hequr të drejtën e ankimimit pranë AK.

Duke vijuar më tej me veprimet antiligjore të AK sjellim në vemendje se KSHA nuk është marrë vetëm me shqyrtimin e ankesës sonë por ka shtuar arsye të reja me preteksin e ankimimit të OE të tjerë mbi ofertën tonë për të cilat ne duhet të ishim vënë në dijeni më përpara nga KVO dhe të kishim mundësi ankimi pranë AK.

Pavarësisht gjithë sa më sipër, ne kundërshtojmë pretendimet e AK si vijon:

1. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i jep të drejtë kompanisë OES Distrimed sh.p.k në lidhje me mungesën e shprehjen në mënyrë specifike nga ana e KVO për specifikimet teknike të pa plotësuar nga OE. Për këtë arsye KSHA rekomandon rrëzimin e vendimit për mosrespektim të procedurës nga ana e KVO-së.

Sa më sipër vetë KSHA e pranon se KVO ka vepruar në kundërshtim me ligjin e prokurimeve publike dhe e ka rrëzuar vendimin e KVO por kjo nuk është pasqyruar në SPE ku të hiqeshin arsyet e skualifikimit nga ana e KVO-së.

Më tej KSHA vazhdon me shqyrtimin e ankesës për arsye të cilat përsëri nuk na janë bërë të njohura përmes SPE për të cilat duhet të kishim mundësi ankimi pranë AK.

Ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar në nenin 2 të LPP-së janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në respektim të këtyre parimeve si dhe përcaktimeve në rregullat e prokurimit public, ligjvënësi ndan qartësisht dy momente procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një strukturë tjetër, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga KSHA.

Sjellim në vemendje se kryetari i KVO është njëkohësisht edhe anëtar i KSHA dhe kjo është një shkelje flagrante e ligjit ku një anëtar i cili pranon se ka vepruar në mënyrë antiligjore vazhdon të trajtojë të njëjtën ankesë, pra të vlerësojë dhe të shqyrtojë shklejet e veta ligjore.

Neni 78/6/a VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, anëtarët e KSHA/personi i ngarkuar nuk duhet të marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesë

2. Në lidhje me skualifikimin e ofertës suaj si anomalisht të ulët konstatojmë se KVO nuk ka respektuar procedurën e nevojshme për t'i kërkuar OE që të paraqesë me shkrim brenda 3 ditëve shpjegimet e nevojshme në lidhje me elementë të vecantë të ofertës. Gjithashtu në mbështetje të nenit 56 të LPP-së si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66, pika 5, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave verifikon nëse oferta është anomalisht e ulët, u llogarit formula për ofertë anomalisht të ulët nga ku rezultoi se oferta e “O.E.S. Distrimed” sh.p.k

është anomalisht e ulët. Gjithashtu KSHA shqyrtoi dhe argumentin tuaj në lidhje me ofertën për tenderin me objekt “Blerje autoanalizator biokimik”, e protokolluar nga ana jonë me nr. 577 prot., datë 01.06.2019. Informacioni i paraqitur nga kompania juaj nuk e bindi KSHA që pajisja me objekt autoanalizator biokimik mund t’i plotësojë nevojat e institucionit tonë. Gjithashtu kompania që ju ka dërguar përgjigjen, nuk korrespondon të jetë e përkthyer në gjuhën shqipe të kërkuar sipas DST.

Kundërshtojmë pretendimin e KSHA në lidhje me pikën 2 pasi sic edhe vetë e ka cituar KSHA e ka rrëzuar vendimin e KVO mbi skualifikimin e ofertës sonë si anomalisht e ulët, pasi nuk ka respektuar procedurën për të kërkuar shpjegime sic e parashikon ligji.

KSHA, në kundërshtim me nenin 56 të LPP, Rregullat e Prokurimit Publik, aplikon në mënyrë të gabuar formulën për ofertat anomalisht të ulta.

Kjo formulë zbatohet vetëm mbi ofertat e kualifikuara, ndërkohë që sipas AK oferta jonë është skualifikuar, dhe KSHA ka patur detyrimin të vlerësojë nëse qëndrojnë arsyet e skualifikimit. Nëse KSHA do të vlerësonte kualifikimin dhe konsiderimin të vlefshëm të ofertës sonë, atëherë aplikonte formulën për ofertat anomalisht të ulëta, sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik.

Pra, pas rrëzimit të vendimit të KVO, në SPE duhet të ish publikuar renditjet e reja si dhe arsyet nëse oferta jonë do të ishte skualifikuar.

Pavarësisht këtij fakti, në argumentimin e ofertës sonë të hartuar në gjuhën shqipe (bashkëlidhur kësaj ankese) janë dhënë të gjithë elementët e ofertës sonë dhe konkretisht si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi	Prodhuesi	Vlera (USD)	Kursi Këmbimit	Vlera (lek)
1	Cmimi blerjes pajisjes	Mindray	7800	110 lekë	858.000
2	Reagente për 5000 analiza	Mindray	500	110 lekë	55.000
3	Transporti ndërkombëtar me ajër + shpenzime të tjera (transfera bankare, shpenzime doganore, regjistrim, transport local, instalim etj.)	Skynet	1300	110 lekë	143.000
4	Fitimi				242.750
5	Oferta				1.298.750

Pra është dhënë e detajuar e gjithë vlera e ofertës sonë që nga cmimi i dhënë nga prodhuesi e deri në realizimin final.

Për të argumentuar këtë është paraqitur edhe komunikimi me email nga prodhuesi mbi ofertën e dhënë për këtë tender.

3. KSHA shqyrtoi të gjithë dokumentacionin dhe konstatoi që ka mungesë konkretisht në pikat:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatën CE Full Quality Assurance System të prodhuesit sipas Direktivave 93/42/EEC dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, të prodhuesit, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin

e hapjes dhe dorezimit te ofertave. Certifikata duhet nga organet certifikuese nderkombetare dhe te jete per secilin artikull specifik te ofruar ne kete procedure prokurimi.

Pra, kompania juaj ka paraqitur një certifikatë sipas direktivave 98/79 EEC e jo sipas direktivave 93/42/EEC të kërkuara nga ana jonë.

2.3.6. Kopje te vertetuar nga Organet Tatimore te List Pageses se Sigurimeve Shoqerore te gjeneruar nga sistemi elektronike i tatimeve sipas formularit ESIG025 ku te perفشihen dhe emri i Inxhinierit, per periudhen Shkurt 2018- Shkurt 2019.

KSHA konstatoi se kompania juaj ka paraqitur formularët ESIG025 ku inxhinieri është i përfshirë por asnjë nga këto formularë nuk është i vërtetuar nga Zyrat Tatimore me vulë dhe firmë të njomë ose me anë të vulës elektronike të gjeneruara nga tatimet.

Për këtë arsye e konsiderojmë këtë kriter të pa përmbushur nga kompania juaj sipas DST dhe kriterëve të kërkuara.

Gjatë periudhës së ankimimit ka një ankesë drejtuar ofertës suaj nga operatorë të tjerë ekonomikë me interes të drejtpërdrejtë për këtë procedurë për të rishikuar dhe investiguar mbi kontratat tuaja të ngjashme dhe konkretisht kapacitetet teknike pika 2.3.1.

Nga konstatimet tona në dokumentacionin e tenderit gjendet:

-Një kontratë “Blerje pajisje mjekësore dhe mobilimi për QSH Kamëz datë 18.04.2017 në vlerën 9.754.400 me faturë tatimore datë 10/5/2019 nr.225930307.

-Datë 1/8/2018 cell counter General Farma ft 225933799 në 495.500 pa tvsh.

-31/05/2018 ft nr 225933296 centrifug 390 euro pa tvsh.

-Fat datë 31/10/2017 Genalb Farma nr 225931578 në vlerën 555.000 pa tvsh.

-Datë 3/10/2018 fat nr22593254 Coagulometer 1000 euro pa tvsh.

Kontrata “Blerje pajisje mjekësore dhe mobilimi për QSH Kamëz” datë 18.04.2017 në vlerën 9.754.400 nuk përmbush kriterin për dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme, duke qënë se Aparat Grafie, EkoKardiale dhe Gjinekologjike për laboratorin etj., janë pajisje pa ngjashmëri me autoanalizator biokimik për laboratorin e institucionit tonë.

Faturat e paraqitura për Cell Counter, Pipeta, Mikser Rroller, Fotometer, Analizator urine, Centrifugat dhe Coagulometer nuk konsiderohen si dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme me autoanalizator biokimik.

Për këtë arsye, pretendimi i ngritur kundër kompanisë tuaj për mospërmbushje të kapacitetit teknik, pika 2.3.1 qëndron dhe është i drejtë. Ky kriter është i pa përmbushur nga kompania sipas DST.”

Kundërshtojmë pretendimin e KSHA në lidhje me pikën 3, pasi vetë KSHA në pikën 1 të Vendimit e pranon se KVO ka vepruar në kundërshtim me ligjin e prokurimeve publike dhe e ka rrëzuar vendimin e KVO por kjo gjë nuk është pasqyruar në SPE ku të hiqeshin arsyet e skualifikimit nga ana e KVO. Më tej KSHA vazhdon me shqyrtimin e ankesës për arsye të cilat përsëri nuk na janë bërë të njohura përmes SPE për të cilat duhet të kidhim mundësi ankimi pranë AK.

Sjellim përsëri në vemendje se kryetari i KVO është njëkohësisht edhe anëtari i KSHA dhe kjo është një shkelje e ligjit ku një anëtar i cili pranon se ka vepruar në mënyrë antiligjore të vazhdojë të trajtojë të njëjtën ankesë, pra të shqyrtojë shkeljet e veta ligjore.

Theksojmë se KSHA nuk ka të drejtë që në shqyrtimin e ankesës sonë të trajtojë pika të ankesave të operatorëve të tjerë. Më parë duhej të zbatohej vendimi i dhënë në pikën 1 ku rrëzon vendimin e KVO, të bëhej riklasifikimi dhe më pas të bëhej rivlerësim mbi ankesat e OE të tjerë dhe kjo të pasqyrohej në SPE.

Pavarësisht këtij fakti, ne argumentojmë se i plotësojmë të gjitha pretendimet që KSHA ngre në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin e prokurimeve publike.

- *Në lidhje me pretendimin për pikën 2.3.4. sqarojmë se kemi paraqitur certifikatë CE sipas klasifikimit të Këshillit të Europës direktiva 98/79/EC për pajisjet laboratorike. Kjo vërteton qëllimin për të cilën është vendosur ky kriter që pajisja të ketë CE. AK ka vepruar në mënyrë të njëanshme pasi të gjithë OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur certifikatë të së njëjtës direktivë CE (ose kanë paraqitur Certifikatë 93/42/EC por që nuk ka në objektin e saj pajisjen laboratorike, objekt i kësaj procedure), pasi pajisjet laboratorike sipas Këshillit të Europës klasifikohen tek direktiva IVDD 98/79/EC. Vetë kërkesa 2.3.4. e citon ndër të tjera: ... “dhe klasifikimit të Këshillit të Europës”. Pra certifikata e paraqitur nga OES Distrimed sh.p.k në këtë procedurë prokurimi është sipas klasifikimit të Këshillit të Europës për pajisjet laboratorike dhe sipas kërkesave të DST.*

Pretendimi i KSHA nuk qëndron.

- *Në lidhje me pretendimin për pikën 2.3.6 sqarojmë se listpagesat e paraqitura janë me vulë elektronike (bar kod) nga sistemi i tatimeve dhe autenticiteti është lehtësisht i verifikueshëm. AK, në bazë të ligjit për prokurimet publike rezervon të drejtën të verifikojë çdo dokument të paraqitur në SPE dhe aq më tepër kur një dokument është i lëshuar nga Institucionet Shqiptare verifikimi është edhe më i lehtë.*

Pretendimi i KSHA nuk qëndron.

- *Në lidhje me pikën 2.3.1. për kapacitetin teknik sqarojmë se kemi paraqitur furnizime të ngjashme për pajisjet laboratorike, duke plotësuar kriterin 2.3.1 në vlerën 40% të fondit limit dhe duke e tejkaluar atë.*

Të gjitha pajisjet e përmendura nga KSHA “Cell Counter, Pipeta, Mikser Rroller, Fotometer, Analizatore urine, Centrifugat dhe Coagulometer” janë pajisje laboratorike të njëjta me objektin e kësaj procedure Autoanalizator Biokimik, e cila është pajisje laboratorike, në mesin e pajisjeve të cituara është edhe pajisja Fotometer e cila është pajisje identike me pajisjen e kërkuar në këtë procedurë “Chemistry Analyzer”.

Në nenin 78 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, pika 6 (a) është cituar Titullari i Autoritetit Kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës. Fakti që ky kriter nuk është respektuar nga AK sjell edhe keqinterpretime të kësaj natyre pasi duke mos qënë ekspert të fushës, anëtarët e KSHA nuk kanë njohuritë e duhura mbi llojet e pajisjeve laboratorike dhe si rrjedhojë me dashje ose në mungesë njohurish kanë dhënë një argumentim jashtë logjike dhe në kundërshtim me ligjin e prokurimeve publike.

Pretendimi i KSHA nuk qëndron.

4. *KSHA gjithashtu shqyrtoi dhe dokumentacionin e specifikimeve teknike ku vuri re mungesë në pikat:*

3.1 Disku të përmbajë jo më pak se 50 tuba analizash.

KSHA konstatoi që sipas katalogut të dorëzuar nga ana juaj, disku përmbante 40 tuba analizash dhe 50 tuba sipas specifikimit teknik të kërkuar nga ana jonë.

2.5 Leximi i absorbancës nuk fillon nga 0.0

4.4 Metoda e analizës endpoint, kinetike. Fixed-time, monokromatike/biokromatike, reagentkimike single/dual, turbidmetri, teknologji zgjedhës të elektrodës së joneve, fotometri absorbuese.

KSHA konstatoi se kjo e dhënë nuk paraqitet në katalogun origjinal të kompanisë tuaj.

5.3 Të ketë 40 kyeveta shumëpërdorimshe.

Katalogu i dorëzuar nga kompania juaj e përmbante nr e kyevetave por jo shumëpërdorimshe.

Kundërshtojmë pretendimin e KSHA në lidhje me pikën 4 pasi vetë KSHA në pikën 1 të Vendimit e pranon se ka vepruar në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe e ka rrëzuar vendimin e KVO por kjo nuk është pasqyruar në SPE ku të hiqeshin arsyet e skualifikimit nga ana e KVO.

Më tej KSHA vazhdon me shqyrtimin e ankesës për arsye të cilat përsëri nuk na janë bërë të njohura përmes SPE për të cilat duhet të kishim mundësi ankimi pranë AK.

Sjellim përsëri në vëmendje se kryetari i KVO është njëkohësisht edhe anëtar i KSHA dhe kjo është një shkelje tjetër e ligjit ku një anëtar i cili pranon se ka vepruar në mënyrë anti ligjore të vazhdojë të trajtojë të njëjtën ankesë, pra të shqyrtojë shkeljet e veta ligjore.

Gjithashtu KSHA nuk ka të drejtë që në shqyrtimin e ankesës sonë të trajtojë edhe pika të ankesave të operatorëve të tjerë.

Më parë duhej të zbatohet vendimi i dhënë në pikën 1 ku rrëzon vendimin e KVO, të bëhet riklasifikimi dhe më pas të bëhet rivlerësim mbi ankesat e OE të tjerë dhe kjo të pasqyrohet në SPE.

Pavarësisht këtij fakti, ne argumentojmë se i plotësojmë të gjitha pretendimet që KSHA ngre në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin e prokurimeve publike.

- Në lidhje me pikën 3.1 sqarojmë se pajisja e ofruar nga ne e plotëson këtë specifikim.

Në katalogun original të pajisjes faqe 2 (ose katalogu i përkthyer në faqet 3 dhe 5) thuhet konkretisht:

Deri në 80 pozicione kampionesh (tuba analizash)

Deri në 80 pozicione reagentësh (shishe reagentësh)

40 fikse dhe 40 të shkëmbyeshme

Përsa më sipër, kapaciteti maksimal i diskut është që të mbajë 80 tuba analizash.

Kjo pasi disku ka kapacitet që të mbajë 40 pozicione fikse për tuba analizash, 40 pozicione fikse për shishe reagentësh dhe 40 pozicione të konvertueshme/shkëmbyeshme ndërmjet shisheve të reagentëve dhe tubave të analizave.

Kjo lehtësisht e verifikueshme edhe në figurën e paraqitur të diskut në katalog faqe 2, ku në pozicionet 1 dhe 2 të rrjeshtit të mesëm të diskut janë vendosur tuba analizash për të vërtetuar shkëmbimin ndërmjet tubave/shisheve në këtë rrjesht me 40 pozicione.

Pra pajisja mund të përdoret me një konfigurim 50 (40+10) pozicione për tuba analizash dhe 70 (40+30) pozicione për shishe analizash duke plotësuar specifikimin e kërkuar më sipër.

Pra specifikimi i mësipërm plotësohet 100% nga pajisja e ofruar dhe pretendimi i KSHA nuk qëndron.

- *Në pikën 2.5 sqarojmë se specifikimi në fjalë plotësohet 100% nga pajisja e ofruar nga ne. Në katalogun origjinal të pajisjes, faqe 8, (ose katalogu i përkthyer në faqet 9 dhe 17) citohet konkretisht:*

Diapazoni Absorbimit: 0-4.0 Abs (konvertim 10 mm), rezolucioni 0.0001 Abs

Pra specifikimi i mësipërm plotësohet 100% nga pajisja e ofruar.

Pretendimi i KSHA nuk qëndron.

- *Në lidhje me pikën 4.4 sqarojmë se specifikimi në fjalë plotësohet 100% nga pajisja e ofruar nga ne. Në katalogun origjinal të pajisjes faqe 8 (ose katalogu i përkthyer në faqet 9 dhe 17) citohet qartë:*

Parimet e matjes: Absorbance fotometrike, turbimetri, teknologji zgjedhese të elektrodës së joneve.

Metodologjia: endpoint, Fixed-time, kinetike, ISE opsionale, reagent kimik single/duale, monokromatike, bi-kromatike.

Pra specifikimi i mësipërm plotësohet 100% nga pajisja e ofruar.

Pretendimi i KSHA nuk qëndron.

- *Në lidhje me pikën 5.3 sqarojmë se specifikimi plotësohet 100% nga pajisja e ofruar nga ne. Në katalogun origjinal të pajisjes faqe 8 (ose katalogu i përkthyer në faqet 9 dhe 17) citohet qartë:*

Rotori i reaksionit: mbajtëse rrotulluese mban 40 kyveta

Kyveta: shumëpërdorimshme, gjatësia optike 5 mm.

Specifikimi i këkuar ofrohet dhe plotësohet 100% nga pajisja e ofruar.

Pretendimi i KSHA nuk qëndron.

5. *Gjatë periudhës së ankimimit ka ardhur një ankesë drejtuar ofertës tuaj nga operatorë të tjerë ekonomikë me interes të drejtpërdrejtë për këtë procedurë për të rishikuar dhe investiguar mbi mosplotësimin e kriterit 7.3 ku kërkohet që kompania të ketë staf të trajnuar për pajisjen e cili është objekt prokurimi, të shoqëruar me certifikatë.*

KSHA konstatoi se në dokumentat e dorëzuara nga kompania OES Distrimed sh.p.k ekziston si më poshtë:

- *Kontrata me inxhinierin A.Prendi, CV dhe diploma plotësojnë kriteret e tenderit.*
- *Gjithashtu kompania ka paraqitur një certifikatë pjesëmarrje nga data 27/11/2018 deri në datën 28/11/2019 në kursin Biochemistry Anylizer BS-240, të lëshuar nga kompania Mindray. Certifikata e pjesëmarrjes nuk është certifikatë trajnimi për suportin dhe mirëmbajtjen e pajisjes. Për këtë arsye e konsiderojmë këtë kriter të papërbushur nga kompania juaj.”*

Kundërshtojmë pretendimin e KSHA në lidhje me pikën 5 pasi vetë KSHA në pikën 1 të Vendimit e pranon se KVO ka vepruar në kundërshtim me ligjin e prokurimeve publike dhe e ka rrëzuar vendimin e KVO por kjo nuk është pasqyruar në SPE ku të hiqeshin arsyet e skualifikimit nga ana e KVO. Më tej KSHA vazhdon me shqyrtimin e ankesës për arsye të cilat përsëri nuk na janë bërë të njohura përmes SPE për të cilat duhet të kishim mundësi ankimimi pranë AK.

Sjellim përsëri në vëmendje se kryetari i KVO është njëkohësisht edhe anëtar i KSHA dhe kjo është një shkelje tjetër e ligjit ku një anëtar i cili pranon se ka vepruar në mënyrë anti ligjore, të vazhdojë të trajtojë të njëjtën ankesë, pra të shqyrtojë shkeljet e veta ligjore.

Gjithashtu KSHA nuk ka të drejtë që në shqyrtimin e ankesës sonë të trajtojë edhe pika të ankesave të operatorëve të tjerë.

Më parë duhej të zbatohej vendimi i dhënë në pikën 1 ku rrëzon vendimin e KVO, të bëhej riklasifikimi dhe më pas të bëhej rivlersim mbi ankesat e OE të tjerë dhe kjo të pasqyrohej në SPE. Pavarësisht këtij fakti, ne argumentojmë se e plotësojmë këtë pretendim që KSHA ngre në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjine prokurimeve publike.

- *Në lidhje me kërkesën 7.3 ne kemi paraqitur certifikatën e trajnimit të lëshuar nga prodhuesi për pajisjen e ofruar në këtë procedurë prokurimi, modeli BS-240.*

Certifikata ka objekt: Technical Training 2018/11/27-2018/11/28 (Trajnim Teknik 27/11/2018-28/11/2018) me vlefshmëri 2 vjecare.

Trajnimi teknik përfshin instalimin, mirëmbajtjen, riparimin, asistencën teknike dhe trajnim mbi përdorimin.

Duke marrë në konsideratë të gjitha faktet e sipërcituara, të cilat provojnë qartazi përmbushjen e kërkesave administrative ligjore, teknike financiare të përcaktuara nga AK, veprimet antiligjore të këtij të fundit në vlerësimin e ofertës sonë, bazuar në parashikimet e neneve 46, 53 dhe 55 të LPP, kërkojmë kualifikimin e ofertës sonë dhe lidhjen e kontratës.”

II.4. Në datën 27.05.2019 operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet:

“[...] Në datën 21.05.2019 nëpërmjet faqes on-line eëë.app.gov.al jemi njoftuar se oferta e shoqërisë sonë është skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi në mënyrë absurd dhe pa një argument konkret por vetëm duke përsdorur një automesazh si më poshtë:

“Operatori nuk plotëson specifikat teknike sipas DST

Specifikimet teknike nuk janë sic parashikohen në DST

Operatori nuk plotëson kriteret teknike të vendosura në DS”,

duke mos qënë dakort me këtë mënyrë flagrante antiligjore për skualifikim të ofertës sonë, duke mos dhënë asnjë argument apo arsye për skualifikimin e shoqërisë sonë në mbështetje të ligjit të prokurimit publik.

Së pari ju bëjmë me dije se anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave kanë skualifikuar ofertën tonë duke mos përdorur asnjë bazë ligjore dhe mbi të gjitha duke shkelur nenin 2 të LPP-së [...]. Duke mos qënë dakort me mënyrën antiligjore të përdorur, duke mos dhënë asnjë arsye nga ana e KVO për skualifikimin e ofertës po ju rikujtojmë që pajisja e ofertuar jo vetëm që i plotëson të gjitha pikat e kriterëve teknike dhe ju ftojme të kryeni detyrën për vlerësim të dokumentave të paraqitura. Nga ana teknike po ju theksojmë se pajisja e ofertuar nga ne kryen 300 teste në orë dhe që i bie 50% me shumë nga cfarë është kërkuar. Konkretisht 300 teste në orë nga 200 cfarë kërkohet. Kërkohen 380 teste me ISE, ne ofertojmë 450. Kërkohet të paktën 50 vende për mostra, ne ofertojmë 115. Kërkohen 50 pozicione për reagentët, ne ofertojmë 67. Kërkohen 40 kyveta ndërsa ne ofrojmë 3 fishin 120 kyveta. Kërkohen 8 filtra, ne ofertojmë 12 filtra. Kërkohet funksioni STAT po ashtu i ofruar nga ne. Duket qartë që KVO as nuk ka marrë mundimin të shkarkojë dhe të lexojë dokumentacionin e dorëzuar nga ne. Bazuar në kërkesa ligjore oferta e shoqërisë tonë plotëson 100% të specifikimeve

teknike dhe tejkalon ato duke favorizuar fluksin në rritje të Qendrës Shëndetësore të Specialiteteve Nr.1 dhe urgjencat kombëtare. Oferta jonë ekonomike është gjithashtu me një leverdi të madhe për AK tuaj pasi ju kursen 1.430.000 lekë. KVO në mënyrë absurd dhe jo ligjore nuk shqyrton fare dokumentacionin e ofertës sonë ekonomike si një vlerë e favorshme por vlerëson dhe kualifikon një ofertë që është 410.000 lekë më e lartë se oferta jonë”

II.4.1. Nëpërmjet shkresës nr. 581 prot., datë 03.06.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje shoqërisë “Fedos” sh.p.k, duke e refuzuar ankesën si vijon:

“1. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i jep të drejtë kompanisë “Fedos” sh.p.k në lidhje me mungesën e shprehjes në mënyrë specifike nga ana e KVO për specifikimet teknike të paplotësuara nga OE. Për këtë arsye KSHA rekomandon rrëzimin e vendimit për mos respektim të procedurës nga ana e KVO.

2. Në lidhje me skualifikimin e ofertës suaj si anomalisht e ulët konstatojme se KVO nuk e ka respektuar procedurën e nevojshme për t'i kërkuar OE të paraqesë me shkrim brenda 3 ditëve shpjegimet e nevojshme në lidhje me elementë të vecantë të ofertës. KSHA verifikoi nëse oferta është anomalisht e ulët, u llogarit formula për ofertë anomalisht të ulët nga ku rezultoi se oferta e Fedos sh.p.k është anomalisht e ulët.

3. KSHA shqyrtoi të gjithë dokumentacionin dhe konstatoi se ka mangësi konkretisht në kapacitetet teknike pika 2.3.4 - Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikaten CE Full Quality Assurance System të prodhuesit sipas Direktivave 93/42/EEC dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, të prodhuesit, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave. Certifikata duhet nga organet certifikuese ndërkombetare dhe të jete per secilin artikull specifik të ofruar në kete procedure prokurimi.

Pra nga ana juaj nuk është paraqitur asnjë certifikatë me këto specifika.

2.3.2 -Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose broshurë me të dhënat teknike për pajisjet e ofruara, të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar. Në katalog, të markohet në menyrë të qartë dhe të dallueshme secila nga pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar, si dhe të markohen specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST.

Katalogu i paraqitur nga ana juaj ishte në anglisht dhe jo i perkthyer qartë në gjuhën shqipe të kërkuar nga ana jonë, gjithashtu dhe e padallueshme pasi ishte me gërma jashtëzakonisht të vogla, duke na e bërë leximin pothuajse të pamundur.

c.Sigurimin e ofertës (nëse është e zbatueshme) sipas shtojcës 4, kjo e dhënë nuk është paraqitur nga kompania juaj.

Gjatë periudhës së ankimit ka një ankesë drejtuar ofertës suaj nga opertaprë te tjerë ekonomikë me interes të drejtpërdrejtë për këtë procedurë për të rishikuar dhe investiguar mbi kontratat tuaja të ngjashme dhe konkretisht kapacitetet teknike pika 2.3.1.

Nga konstatimet tona në dokumentacionin e tenderit gjendet

- Kontrata e furnizimeve dt 27.11.2018 me Spitalin Rajonal Lezhë me objekt Furnizim vendosje pajisje mjekësore për Spitalin Lezhë, ku janë ofruar Monitor Pacienti, ECK, Nebulizator në vlerën 2.400.000

- Kontratë dt. 23/06/2018 me Qendrën Shëndetësore të Specialiteteve nr. 2 Tiranë nr. 129 prot, me objekt Blerje Aparature Mjekësore për shërbimin e Fizioterapisë në vlerën 5.008.800 lekë me tvsh.

Kontrata “Kontratë furnizimi me Spitalin Rajonal Lezhë” datë 27.11.2018 në vlerën 2.400.000 lekë pa tvsh nuk përmbush kriterin për dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme duke qënë se Monitor dhe Nebulizator janë pajisje spitalore pa ngjashmëri me Autoanalizatorin Biokimik për laboratorin e institucionit tonë.

Kontrata e dt 23.06.2018 me Qendrën Shëndetësore të Specialiteteve nr. 2 Tiranë nr. 129 prot., me objekt “Blerje aparature Mjekësor” për shërbimin e fizioterapisë, në vlerën 5.008.800 lekë me tvsh, nuk konsiderohet si dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme me autoanalizator biokimik për laboratorin e institucionit tonë. Për këtë arsye pretendimi i ngritur kundër kompanisë Fedos për mospërmbushje të kapacitetit teknik, pika 2.3.1 qëndron dhe është i drejtë. Ky kriter është i papërmbushur nga kompania sipas DST.

4. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjithashtu shqyrtoi dhe dokumnetacionin e specifikimeve teknike ku vuri re mungesë në pikat:

2.3 Pajisja realizonte ftohje 24 orë por në temperaturë 5-15 c, jo në temperaturë 2-12 c të kërkuar nga ana jonë.

2.5 Leximi i absorvancës nuk fillon 0.0

5.5 Konsumi i ujit jo më shumë se 4 l/orë, nuk ekziston kjo e dhënë në katalogun e paraqitur nga ana juaj

6.5 Nuk kishte të dhëna që pajisja ishte prodhim i dy viteve të fundit (2017-2018)

5.3 Të ketë 40 kyeveta shumëpërdorimshe, është e vërtetë që ju ofroni 3 fishin por jo shumëpërdorimshe.

5.4 Larja automatike e kryevetave, nuk ekziston kjo e dhënë në katalogun e paraqitur nga ana juaj.

5. Gjatë periudhës së ankimimit ka ardhur një ankesë drejtuar ofertës suaj nga operatprët e tjerë ekonomikë me interes të drejtëpërdrejtë për këtë procedurë për të rishikuar dhe investiguar mbi mos plotësimin e kriterit 7.3 ku kërkohet që kompania të ketë staf të trajnuar për pajisjen i cili është objekt prokurimi, të shoqëruar me certifikatë.

KSHA konstatoi se në dokumentat e dorëzuar nga kompania Fedos sh.p.k ekzistojnë si më poshtë:

Për inxhinierin O.Struga

- Vërtetim nga kompania SEAC/RADIM për njohuritë nga trajnimi për aparat gjaku GENIUS, Fotometer , Slim, Koagulometer Clot 2, Elisa Sirio.
- Certifikatë për trajnim në inxhinieri klinike në Suedi për kujdesin shëndetësor
- Certifikatë pjesëmarrje në Konferencë nga RADOX
- Certifikatë trajnimi për Sterilizator Avulli të firmës MATACHANA Spain
- Certifikatë për njohuritë për pajisje e SEAC/RADIM
- Vërtetim që ka kaluar me sukses kursin Sistemet X-RAY nga Akademia e sistemeve mjekësore Philips
- Certifikatë për pajisjet Ultrasound
- Certifikatë pjesëmarrje për monitorimin e pacientit

- *Certifikatë trajnimi për pajisjet Hemodializë Diadvance dhe Dialife*

KSHA nuk gjeti asnjë certifikatë trajnimi për mirëmbajtjen dhe suportin e pajisjes CS-300 B apo serie të kësaj kategorie pajisjesh të prodhuar nga kompania Kineze DIRUI. Duke qënë se ky kriter është esencial për këtë procedurë dhe për garantimin e suportit, mirëmbajtjes dhe mirëfunksionimin e Autoanalizatorit Biokimik, e konsiderojmë këtë kriter të pa përmbushur nga kompania juaj.”

II.4.2. Në datën 11.06.2019 operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor. Gjithashtu pretendohet si vijon:

[...]

Duke mos qënë dakort me një vendim absurd dhe të qëllimshëm nga ana e KVO-së dhe gjithashtu nga një vendim subjektiv, joprocedural dhe të mbështetur në aludime të operatorëve konkurrent nga ana e KSHA, po ju japim më poshtë argumentat tona:

1. *Fillimisht KVO në mënyrë shumë absurde dhe të qëllimshme bën skualifikimin e ofertës sonë ekonomike, duke mosrespektuar detyrimet që i ngarkon ligji. Kjo e vërtetuar dhe shprehur qartë nga vendimi i KSHA për këtë pikë.*

Duke mos qënë dakort me skualifikimin e ofertës sonë jemi drejtuar AK me ankesë kundër vendimit të KVO për mosshqyrtim të ofertës sonë sipas DST dhe LPP, ankesë të cilën KSHA e shikon të drejtë dhe jep argumentin [...]. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i jep të drejtë kompanisë Fedos sh.p.k në lidhje me mungesën e shprehjes në mënyrë specifike nga ana e KVO për specifikimet teknike të paplotësuara nga OE. Për këtë arsye KSHA rekomandon rrëzimin e vendimit për mosrespektim të procedurës nga ana e KVO.

2. *Në vazhdimësi të përgjigjes së KSHA në mënyrë jo ligjore dhe absurde kemi një vlerësim të ofertës sonë mbi aludime të operatorëve të tjerë ekonomikë dhe jo objekt i ankimimit tonë, i cili mbështetet vetëm në DST.*

KSHA del jashtë tagrit që i jep ligji për shqyrtimin e ankesës dhe bën rolin e një KVO të dytë duke bërë arsyetime, vlerësime subjektive, në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në SPE, tërësisht pa lidhje me objektin e ankimimit dhe duke tejkaluar kompetencat e saj ligjore.

Në kushtet që ndodhesh KSHA, në mungesë të plotë të argumentave nga KVO për skualifikimin e ofertës tonë, mund të merrte vendim që KVO të rivlerësonte ofertën dhe të jepte argumentat e arsyet e skualifikimit apo kualifikimit të saj – dhe jo të bënte vlerësim të ofertës si KVO e dytë.

KSHA në pikën 2 të përgjigjes së saj, vetkrijon dhe vetpërgjigjet për një pretendim që nuk është në ankesën drejtuar KVO. Konkretisht për skualifikim për ofertë anomalisht të ulët. Pika 2... Në lidhje me skualifikimin e ofertës suaj si anomalisht të ulët kostatojmë se KVO nuk ka respektuar procedurën e nevojshme për t'i kërkuar OE që të paraqesë me shkrim brenda 3 ditëve shpjegimet e nevojshme në lidhje me elementë të vecantë të ofertës. Nga analizimi i përgjigjes së KSHA vëmë re një vlerësim të qëllimshëm, jo të drejtë, subjektiv dhe absurd në kontekstin e çështjes. Referuar përgjigjes së KVO për skualifikim të ofertës sonë, nuk përmendet një pikë e tillë. Nuk jemi skualifikuar për ofertë anomalisht të ulët – KSHA del jashtë tagrit të saj.

KSHA në pikën 3 të përgjigjes së saj pretendon një Certifikatë CE Full Quality Assurance System të prodhuesit sipas direktivave 93/42/EEC dhe klasifikimit të Këshillit të Europës.

KSHA sërish del jashtë kontekstit dhe objektit të prokurimit, duke treguar një mosprofesionalizëm teknik të theksuar.

Pajisja që AK ka prokuruar sipas klasifikimit të Këshillit të Europës e shprehur dhe në DST bën pjesë në kategorizimin IVDD dhe certifikohet me standardet 98/79/ec. Direktiva e kërkuar nga KSHA 93/42/EEC nuk është objekt i këtij prokurimi dhe si i tillë nuk mund të jetë paraqitur nga asnjë operator pasi nuk ekziston për një pajisje laboratorike IVDD.

KSHA në mënyrë tendencioze dhe joprofesionale, po brenda pikës 3, deklaroi se nuk kemi paraqitur katalog në gjuhën shqipe dhe që katalogu në anglisht është me gërma jashtëzakonisht të vogla, duke bërë leximin pothuajse të pamundur.

Fillimisht ju bëjmë me dije që në sistemin online të APP është ngarkuar dokumenti Katalogu_i_noterizuar.pdf, i cili është lehtësisht i lexueshëm. Ky dokument përmban katalogun e pajisjes dhe është i përkthyer me nr noterial 1854, datë 15.05.2019 nga përkthyesja znj. E.Vrenezi. KSHA në këtë rast gënjen për mungesën e katalogut në gjuhën shqipe. Referuar kërkesave të DST për pranim të katalogut vetëm në mënyrë elektronike, nuk është nën përgjegjësinë tonë mënyra e printimit apo cilësia e printerit të zyrës përgjegjëse në AK. Është vetë KSHA që në pikën 4 të përgjigjes së saj thotë që operatori nuk plotëson kërkesat teknike të pajisjes, duke përmendur disa pika. Lind pyetja se ku është referuar KSHA për të nxjerrë këto specifikime që mungojnë? Pra katalogu paska qënë në shqip dhe shume mirë i lexueshëm nga KSHA, përse kohë janë bërë krahasime të specifikimeve teknike.

KSHA në vazhdimësi të të qënurit jashtë objektit të detyrave të ngarkuara, shkon dhe më tej duke dalë jashtë kontekstit ligjor të prokurimeve publike. Në vazhdimësi të pikës 3 deklaroi në gërmën “c” që OE Fedos nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas shtojcës 4.

KSHA nuk është bazuar në Vendimin nr. 797, datë 29.12.2017 ku shprehet qartë në nenin 12: Në pikën 1, të nenit 18 “Sigurimi i ofertës” shtohet një fjali, me këtë përmbajtje: “Sigurimi i ofertës nuk kërkohet në procedurat e prokurimit me vlerë më të ulët se kufiri i lartë monetar”.

Pra ligji specifikon qartë që sigurimi i ofertës nuk duhet të kërkohet. Duke qënë se as në DST nuk kërkohet të jetë e zbatueshme kjo tregon qartë që vlerësimet e KSHA nuk kanë pikë referimi DST apo LPP – kjo një paafësi e qartë nga ana e KSHA.

Po në vazhdimësi të pikës 3 po ashtu edhe në pikën 5 KSHA devijon serisht nga objekti i ankesës dhe nuk merret me shqyrtimin e ankesës sonë ndaj KVO por merret me ankimimet që mund të kenë ardhur për këtë procedurë prokurimi. Nga konkluzionet e arritura për këto dy pika dhe të përdorura si shkak për skualifikim, duket qartë që KVO nuk është marrë me DST dhe dokumentacionin e ngarkuar në APP por ka përdorur aludimet/shpifjet e operatorëve ekonomikë të interesuar për skualifikimin e ofertës sonë. Në lidhje me kontratat që kemi paraqitur jemi bazuar në kërkesta e DST dhe specifikisht ... furnizime të ngjashme dhe jo furnizime të njëjta. Të dyja kontratat janë pajisje mjekësore, pra pajisje të ngjashme me objektin e prokurimit dhe plotësojnë shumën e kërkuar.

Në lidhje me inxhinierët ju sqarojmë që fillimisht KSHA bën verifikim dhe vlerëson duke mos u bazuar në dokumentat shoqëruese të ofertës së paraqitur në faqen e APP për këtë procedurë prokurimi. Në APP janë ngarkuar 2 dokumenta me emërtimet Eng.O.Struga dhe Eng. L. Peci dhe KSHA bën vlerësim të pjesshëm, duke u marrë me aludimet e operatorëve të tjerë dhe jo me atë cfarë OE Fedos ka paraqitur në këtë procedurë.

Së dyti, vetë KSHA ka nxjerrë listën e trajnimeve të Eng.O.Struga dhe sic kërkohet në DST është i trajnuar për pajisjen objekt i këtij prokurimi, Autoanalizator Biokimik. Firmat si SEAC/RADIM apo RADOX janë prodhues global të mirënjohur për këtë kategori pajisjesh dhe ky fakt e bën të pavërtetë pretendimin e KSHA.

Bëjmë me dije që të dy inxhinierët e Fedos sh.p.k janë me status Inxhinier Klinik me një eksperiencë përkatësisht 19 dhe 5 vjecare, pikërisht në fushën e inxhinierisë mjekësore. OE Fedos ka në mirëmbajtje të vazhdueshme prej disa vitesh autoanalizatorin aktual të instaluar në laboratorin e AK. Duke qënë se ky kriter është esencial për KSHA, OE Fedos i ka ofruar të gjitha mundësitë si në burime njerëzore maksimale për të garantuar instalimin me sukses, trajnimin nga ana teknike dhe klinike po ashtu dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Vetë AK juaj mund ta vërtetojë këtë, pa pasur nevojë për ankesa apo aludime nga operatorë të tjerë konkurrentë. KSHA nuk ka marrë në shqyrtim asnjë pikë të ankesës tonë, por ka bërë edhe aludime e ka përdorur informacione të pabazuara në dokumenta zyrtare.

Gjithashtu KSHA në mënyrë absurde dhe tërësisht të padrejtë akuzon shoqërinë “Fedos” sh.p.k se nuk plotëson specifikimet teknike.

Sqarojmë edhe nga ana teknike:

2.3 Pajisja realizonte ftohje 24 orë por në temperaturë 5-15 c, jo në temp 2-12 c të kërkuar nga aan jonë.

2.5 Leximi i absorvancës nuk fillon 0.0

5.5 Konsumi i ujit jo më shumë se 4 l/orë, nuk ekziston kjo e dhënë në katalogun e paraqitur nga ana juaj

6.5 Nuk kishte të dhëna që pajisja ishte prodhim i dy viteve të fundit (2017-2018)

5.3 Të ketë 40 kyeve të shumëpërdorimshe, është e vërtetë që ju ofroni 3 fishin por jo shumëpërdorimshe.

5.4 Larja automatike e kryevetave, nuk ekziston kjo e dhënë në katalogun e paraqitur nga ana juaj.

-Në lidhje me pretendimet teknike të pikës 2.3 sqarojmë që specifikimi i përmendur ka të bëjë me reagentin dhe jo pajisjen. Reagentët për të cilët kërkohet pajisja janë biokimike dhe temperatura optimale është 8-12°C. Duke e parë në aspektin funksional intervali 5-15°C ofron qëndrueshmëri më të lartë dhe siguron mbarëvajtjen e analizave të AK tuaj.

-Në lidhje me pikën 2.5 KSHA nuk lexon/jep informacionin e saktë pasi në katalog është shumë qartë e theksuar që absorbanca është 0-3.3 Abs.

-Në lidhje me pikën 5.5 pajisja nuk mund të ketë një vlerë të saktë pasi kjo varet nga përdorimi ditor, numri i QC, Kalibrimeve etj. Ky specifikim nuk ndikon në objektin e kësaj blerje pasi është i papërfillshëm në lidhje me funksionin e pajisjes.

-Në lidhje me pikën 6.5, në rradhë të parë, kjo nuk është në kërkesat teknike të pajisjes dhe nuk është një informacion që mund të gjendet në katalogun e saj, por është si kërkesë më vete dhe për të cilën është lëshuar deklaratë nga OE Fedos. Në rradhë të dytë, një prodhues nuk mund të hamëndësojë kohën kur një autoritet diku në botë mund të bëjë blerje pasi katalogu mund të jetë i krijuar para vitit 2017 ose 2018 dhe nuk mund të shkruhet dicka që nuk është e vërtetë.

-Në lidhje me pikën 5.3 dhe 5.4, pasi janë të lidhura bashkë, KSHA sërish nuk jep informacionin e saktë pasi në katalog shkruhet shumë qartë që pajisja bën larje dhe mbi të gjitha e ngroh vetë ujin dhe ky specifikim bën të qartë që kyvetat janë shumë përdorimshe dhe mbi të gjitha ku është kërkuar

me diametër 5 mm që e bën të pallogjikshëm ngritjen e këtij pretendimi. Pajisja nuk mund të ofrojë larjen e kyvetave njëpërdorimshe.

Kërkojmë pranimin e ankesës sonë, kualifikimin e ofertës së Fedos sh.p.k si të rregullt dhe me leverdi të lartë ekonomike, pasi vendimi i KVO dhe më pas i KSHA është marrë duke mos u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe atë plotësues të ofertës ekonomike të paraqitur nga ana e shoqërisë Fedos sh.p.k.”

II.5. Në datën 27.05.2019 operatori ekonomik “Biomedica Albania Distribution” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si më poshtë vijon:

“Për kompaninë “Genius” sh.p.k të kualifikuar nga ju, prezantojmë disa fakte si më poshtë, që mund të shërbejnë për skualifikimin e kësaj kompanie:

Fakti nr.1:

Në DST kërkohet:

“Kërkohet nga OE te paraqesin Autorizim Prodhimi nga Prodhuesi i derjteperdrejte, ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi per shitjen dhe mirembajtjen e pajisjeve per institucionin dhe kete tender specifik.”

Kemi dyshime serioze se kompania “Genius” sh.p.k nuk përmbush kriterin e modifikuar nga ju në lidhje me autorizimin specifik për këtë procedurë ku të përfshihet shitja dhe mirëmbajtja e pajisjeve. Mungesa e një autorizimi specifik të lidhur me këtë procedurë tenderuese rrezikon realizimin, suportin, mirëmbajtjen dhe termat e garancisë. Kërkojmë të investigoni në lidhje me këtë fakt dhe të jepet një qëndrim zyrtar në lidhje me përmbushjen ose jo të këtij kriteri.

Fakti 2:

Në DST kërkohet:

“Kopje te vertetuar nga Organet Tatimore te List Pageses se Sigurimeve Shoqerore te gjeneruar nga sistemi elektronike i tatimeve sipas formularit ESIG025 ku te perfshihen dhe emri i Inxhinierit, per periudhen Shkurt 2018- Shkurt 2019.”

Kemi dyshime serioze se kompania “Genius” sh.p.k nuk ka paraqitur formularin ESIG025. Në mënyrë specifike formulari ESIG025 është kërkuar të jetë i vërtetuar nga organet tatimore, ku format e vetme janë ose nëpërmjet formularit të vulosur elektronikisht ose nëpërmjet formularit të vulosur dhe firmosur nga tatimet me vulë të njomë. Cdo formular tjetër shkel kriteret e tenderit. Kërkojmë të investigoni në lidhje me këtë fakt dhe të jepet një qëndrim zyrtar në lidhje me përmbushjen ose jo të këtij kriteri.

Fakti nr.3

“1.2. Pajisja duhet te disponoje me shpejtesi jo me te vogel se 380 teste/ ore, me modul ISE modul Na, K, Cl.”

Në bazë të katalogjeve dhe CE, kompania “Genius” sh.p.k nuk e përmbush këtë kriter në lidhje me ISE modul Na, K, Cl. Për indikacion investigimi mund të analizoni Deklaratën e Konformitetit mbi testet që suportohen nga pajisja.

Fakti nr.4

“Pajisja duhet te kete rreth jo me pak se 50 pozicione per reagentet (40 prej te cileve te jene te fiksuara).”

Kompania "Genius" sh.p.k nuk e përmbush këtë kriter teknik me pajisjen që ofron dhe ka më pak se 50 pozicione për reagentë. Në katalogun e pajisjes së kompanisë "Genius" sh.p.k specifikohet "Up to 72 reagents can be located into therefrigerated compartment and distributed on: 4 removable racks". Pra i bie që janë 18 reagene të fiksuar dhe jo 40 reagentë sic kërkohet në kriteret teknike të tenderit pika 1.3.

Për kompaninë "OES Distrimed" sh.p.k të skualifikuar, dëshirojmë që të sjellim disa fakte që do të ndihmojnë Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave në një vendimarrje sa më të kualifikuar dhe asnjansë për një rankim sa më të drejtë dhe objektiv.

Fakti nr. 1

Në bazë të konstatimit mbi cmimin e ofruar kjo kompani ka bërë një ofertë ekonomike anomalisht të ulët.

A mund të konfirmoni që kjo ofertë është anomalisht e ulët dhe a janë dhënë argumentat nga kompania për ofertën e saj të ulët? Kemi përshtypjen që një vendimarrje e KVO kaq e shpejtuar nuk ka respektuar procedurën për të pyetur kompaninë për sqarime, për t'i shërbyer një vendimarrje ligjore të argumentuar. Shkelja e procedurës prokurorese rrezikon procedurën në tërësi.

Fakti nr.2.

Në bazë të eksperiencës që kemi në treg dhe mbi konkurrencën në sektorin tonë mund të deklarojmë se kompanisë "OES Distrimed" sh.p.k i mungojnë kontratat e ngjashme në lidhje me tregtimin, suportin, mirëmbajtjen dhe garancinë e autoanalizatorit biokimik. Kompania mund të ketë dhe ofrojë produkte të tjera (si hematologjike, coagulimi, etj), por nuk janë të ngjashme dhe nuk futen në klasën dhe objektin e kërkuar nga autoriteti juaj. Pra a mund të konfirmoni dhe vërtetoni përmbushjen e këtij kriteri për kontrata të ngjashme për pajisjet autoanalizator biokimik?

Fakti nr.3.

"7.3. Kompania te kete staf te trajnuar per pajisjen i cili eshte objekt prokurimi te shoqeruar me certifikate."

Duke qënë se kompania "OES Distrimed" sh.p.k nuk ka kontrata të ngjashme, pajisjet që ka filluar të tregtojë së fundmi pa sukses janë produktet kineze. Shtrojmë pikëpyetjen tonë llogjike në lidhje me stafin inxhinier që duhet të suportojë dhe mirëmbajë pajisjen. A është ky staf inxhinierik i trajnuar dhe certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjes? Nëse pajisja dhe kompania prodhuese është në Kinë ngremë shumë dyshime që inxhinieri është trajnuar, ka marrë provimet dhe ka marrë certifikatën e kualifikimit.

Fakti nr.4.

Në DST kërkohet:

"Kopje te vertetuar nga Organet Tatimore te List Pageses se Sigurimeve Shoqerore te gjeneruar nga sistemi elektronike i tatimeve sipas formularit ESIG025 ku te perfshihen dhe emri i Inxhinierit, per periudhen Shkurt 2018- Shkurt 2019."

Kemi dyshime serioze se ashtu si shumë kompani të pa updatuara me teknologjitë dhe risitë e fundit të institucioneve tona dhe kompania "OES Distrimed" sh.p.k nuk ka paraqitur formularin ESIG025. Në mënyrë specifike formulari ESIG025 është kërkuar të jetë i vërtetuar nga organet tatimore, ku format e vetme janë ose nëpërmjet formularit të vulosur elektronikisht ose nëpërmjet formularit të vulosur dhe firmosur nga tatimet me vulë të njomë. Cdo formular tjetër shkel kriteret e tenderit.

Kërkojmë të investigoni në lidhje me këtë fakt dhe të jepet një qëndrim zyrtar në lidhje me përmbushjen ose jo të këtij kriteri.

Fakti nr.5.

“1.2. Pajisja duhet te disponoje shpejtesi jo me te vogel se 380 teste/ ore, me modul ISE modul Na, K, Cl.”

Kompania “OES Distrimed” sh.p.k nuk e përmbush këtë kriter në lidhje me ISE modul Na, K, Cl. Për indikacion investigimi mund të shërbejë Deklarata e Konformitetit mbi testet që suportohen, të cilat nxjerrin që pajisja e ofruar nuk i suporton testet sipas kriterëve. Me sa njohuri kemi ne për pajisjet që kjo kompani ofron, ky kriter nuk plotësohet. Kërkojmë të investigoni në lidhje me këtë fakt dhe të jepet një qëndrim zyrtar në lidhje me përmbushjen ose jo të këtij kriteri.

Për kompaninë “Fedos” sh.p.k të skualifikuar, dëshirojmë që të sjellim disa fakte që do të ndihmojnë Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave në një vendimarrje sa më kualifikuar dhe asnjane për një rankim sa më të drejtë dhe objektiv.

Fakti 1.

“2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Autorizim nga MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE per Tregtim me shumice te pajisjeve mjekesore mbeshetur ne nenet 21 dhe 22 te Ligjit nr. 89/2014, date 17.07.2014.”

Kemi dyshime se kompania “Fedos” sh.p.k nuk zotëron Autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë. A mund të kemi një qëndrim dhe përgjigje zyrtare në lidhje me plotësimin e këtij kriteri?

Fakti 2.

“Vertetim nga Dega e tatim taksave per xhiron mesatare gjatë tre viteve (2016 –2017- 2018) kundrejt vleres se objektit qe Operatori Ekonomik oferton.”

A zotëron kjo kompani këtë vërtetim për xhiron mesatare të tre viteve të fundit? Kemi indikacione mbi problematikat financiare që ka kjo kompani dhe praktikat jo fort të shëndetshme financiare.

Fakti nr.3:

Në bazë të eksperiencës që kemi në treg mbi konkurrencën mund të deklarojmë se kompanisë “Fedos” sh.p.k i mungojnë kontratat e ngjashme në lidhje me tregtimin, suportin, mirëmbajtjen dhe garancinë e pajisjes autoanalizator biokimik. Kompania mund të ketë dhe të ofrojë produkte të tjera por që nuk janë të ngjashme dhe nuk futen në klasën dhe objektin e kërkuar nga ju. Pra a mund të konformoni dhe vërtetoni përmbushjen e kriterit për kontratat e ngjashme për pajisjen autoanalizator biokimik?

Fakti nr.4.

“7.3. Kompania te kete staf te trajnuar per pajisjen i cili eshte objekt prokurimi te shoqeruar me certifikate.”

Duke qënë se kompania “Fedos” sh.p.k nuk ka kontrata të ngjashme, pajisjet që tregton janë produkte me origjinë kineze dhe ne shtrojmë pikëpyetjet tona llogjike në lidhje me stafin inxhinier që duhet të suportojë dhe mirëmbajë pajisjen. A është stafi inxhinierik i trajnuar dhe certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjes? Nëse pajisja dhe kompania prodhuese është në Kinë ngremë shumë dyshime që inxhinieri ka vajtur në Kinë dhe është trajnuar, ka marrë provimet dhe ka marrë certifikatën e kualifikimit.

Fakti nr.5

Në DST kërkohet:

“Kopje te vertetuar nga Organet Tatimore te List Pageses se Sigurimeve Shoqerore te gjeneruar nga sistemi elektronike i tatimeve sipas formularit ESIG025 ku te perfshihen dhe emri i Inxhinierit, per periudhen Shkurt 2018- Shkurt 2019.”

Kemi dyshime serioze se ashtu si shumë kompani të pa updatuara me teknologjitë dhe risitë e fundit të institucioneve tona dhe kompania “Fedos” sh.p.k nuk ka paraqitur formularin ESIG025. Në mënyrë specifike formulari ESIG025 është kërkuar të jetë i vërtetuar nga organet tatimore, ku format e vetme janë ose nëpërmjet formularit të vulosur elektronikisht ose nëpërmjet formularit të vulosur dhe firmosur nga tatimet me vulë të njomë. Cdo formular tjetër shkel kriteret e tenderit. Kërkojmë të investigoni në lidhje me këtë fakt dhe të jepet një qëndrim zyrtar në lidhje me përmbushjen ose jo të këtij kriteri.

Fakti nr.6.

“1.2. Pajisja duhet te disponoje me shpejtesi jo me te vogel se 380 teste/ ore, me modul ISE modul Na, K, Cl.”

Kompania “Fedos” sh.p.k nuk e përmbush këtë kriter në lidhje me ISE modul Na, K, Cl. Për indikacion investigimi shërben Deklarata e Konformitetit ku listohen testet që suportohen ku del në pah që pajisja e ofruar nuk i suporton testet e kërkuara. Me sa njohuri kemi ne për pajisjet që kjo kompani ofron, ky kriter nuk plotësohet. Kërkojmë të investigoni në lidhje me këtë fakt dhe të jepet një qëndrim zyrtar në lidhje me përmbushjen ose jo të këtij kriteri.

Fakti nr.7.

Në bazë të konstatimit mbi cmimin e ofruar kjo kompani ka bërë një ofertë ekonomike anomalisht të ulët.

A mund të konfirmoni që kjo ofertë është anomalisht e ulët dhe a janë dhënë argumentat nga kompania për ofertën e saj të ulët? Kemi përshtypjen që një vendimarrje kaq e shpejtuar nuk ka respektuar procedurën për të pyetur kompaninë për sqarime, për t'i shërbyer një vendimarrje ligjore. Shkelja e procedurës mund të sjellë anulimin e procedurës tenderuese.

Për kompaninë “Farma Net” sh.p.k të skualifikuar, dëshirojmë që të sjellim disa fakte që do të ndihmojnë Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave në një vendimarrje sa më kualifikuar dhe asnjëse për një rankim sa më të drejtë dhe objektiv.

Fakti 1.

“2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Autorizim nga MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE per Tregtim me shumice te pajisjeve mjekesore mbeshetur ne nenet 21 dhe 22 te Ligjit nr. 89/2014, date 17.07.2014.”

Kemi dyshime se kompania “Farma Net” sh.p.k nuk zotëron Autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë. Kërkojmë të investigoni në lidhje me këtë fakt dhe të jepet një qëndrim zyrtar në lidhje me përmbushjen ose jo të këtij kriteri.

Fakti nr.2.

Në bazë të eksperiencës që kemi në treg mbi konkurrencën mund të deklarojmë se kompanisë “Farma Net” sh.p.k i mungojnë kontratat e ngjashme në lidhje me tregtimin, suportin, mirëmbajtjen dhe garancinë e pajisjes autoanalizator biokimik. Kompania mund të ketë dhe të ofrojë produkte të tjera por që nuk janë të ngjashme dhe nuk futen në klasën dhe objektin e kërkuar nga ju. Pra a mund të

konformoni dhe vërtetoni përmbushjen e kriterit për kontratat e ngjashme për pajisjen autoanalizator biokimik?

Fakti nr.3

“7.3. Kompania te kete staf te trajnuar per pajisjen i cili eshte objekt prokurimi te shoqeruar me certifikate.”

Duke qënë se kompania ” Farma Net” sh.p.k nuk ka kontrata të ngjashme, pajisjet që tregton janë produkte kineze dhe ne shtrojmë pikëpyetjet tona llogjike në lidhje me stafin inxhinier që duhet të suportojë dhe mirëmbajë pajisjen. A është stafi inxhinierik i trajnuar dhe certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjes? Nëse pajisja dhe kompania prodhuese është në Kinë ngremë shumë dyshime që inxhinieri ka vajtur në Kinë dhe është trajnuar, ka marrë provimet dhe ka marrë certifikatën e kualifikimit.

Fakti nr.4.

Në DST kërkohet:

“Kopje te vertetuar nga Organet Tatimore te List Pageses se Sigurimeve Shoqerore te gjeneruar nga sistemi elektronike i tatimeve sipas formularit ESIG025 ku te perfshihen dhe emri i Inxhinierit, per periudhen Shkurt 2018- Shkurt 2019.”

Kemi dyshime serioze se ashtu si shumë kompani të pa updatuara me teknologjitë dhe risitë e fundit të institucioneve tona dhe kompania “Fedos” sh.p.k nuk ka paraqitur formularin ESIG025. Në mënyrë specifike formulari ESIG025 është kërkuar të jetë i vërtetuar nga organet tatimore, ku format e vetme janë ose nëpërmjet formularit të vulosur elektronikisht ose nëpërmjet formularit të vulosur dhe firmosur nga tatimet me vulë të njomë. Cdo formular tjetër shkel kriteret e tenderit. Kërkojmë të investigoni në lidhje me këtë fakt dhe të jepet një qëndrim zyrtar në lidhje me përmbushjen ose jo të këtij kriteri.

Fakti nr.5.

“4.1. Sistem i hapur me funksion prioritar STAT.”

Në bazë të eksperiencës sonë, kompania “Farma Net” sh.p.k ofron pajisje me sisteme të mbyllura ku lihet opsionale e hapur. Në bazë të kriterëve që kërkohen pajisjet e ofruara nga “Farma Net” sh.p.k nuk plotësojnë kriterin 4.1 sistem i hapur me funksion prioritar STAT.

Gjithashtu duke u futur në detaje më të thella teknike, për këto pajisje kërkohen shishe të vogla, të mesme dhe të mëdha, ndërkohë që pajisjet e ofruara nga “Farma Net” sh.p.k reagentët janë vetëm me dy shishe.”

II.5.1. Nëpërmjet shkresës nr.582 prot., datë 03.06.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e pranuar pjesërisht ankesën si vijon:

“Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mori në shqyrtim ankesën tuaj drejtuar firmave pjesëmarrëse në procedurën tenderuese dhe bëri investigimet e konkludoi si më poshtë:

Për kompaninë OES Distrimed sh.p.k

- 1. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet se kompania OES Distrimed sh.p.k ka bërë ofertë ekonomike anomalisht të ulët .*

Kompania OES Distrimed ka bërë një ofertë anomalisht të ulët dhe i jepet të drejtë ankimuesit.

- 2. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet se kompania OES Distrimed sh.p.k mungojnë kontratat e ngjashme në lidhje me tregtimin, suportin, mirëmbajtjen dhe garancinë e autoanalizatorëve biokimik.*

Kompania OES Distrimed nuk kontrata të ngjashme dhe i jepet të drejtë ankimesit.

- 3. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet tuaja se Kompania OES Distrimed nuk ka në staf inxhinierë që duhet të suportojnë dhe mirëmbajnë pajisjet e ofruara.*

Kompania OES Distrimed sh.p.k nuk ka inxhinierë të trajnuar dhe të certifikuar për të suportuar pajisjen e ofruar. Për këtë i jepet të drejtë ankimesit.

- 4. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet tuaja se kompania "OES Distrimed" nuk ka paraqitur formularin ESIG 025.*

Kompania OES Distrimed ka paraqitur formularin ESIG 025, por ky formular nuk është as i firmosur dhe as i vulosur. Për këtë arsye i jepet të drejtë ankimesit.

- 5. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet tuaja se kompania OES Distrimed nuk përmbush kriterin teknik 1.2 në lidhje me ISE modul NA, K, CL.*

Në bazë të katalogut Kompania OES Distrimed e përmbush këtë kriter.

Për kompaninë "Genuis" sh.p.k

- 1. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet se kompania "Genuis" sh.p.k nuk përmbush kriterin e modifikuar në lidhje me autorizimin specifik për këtë procedurë duhet të përfshihet shitja dhe mirëmbajtja e pajisjeve.*

Kompania "Genuis" sh.p.k zotëron një autorizim të përgjithshëm dhe jo specifik sipas DST.

- 2. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet se kompania "Genuis" sh.p.k nuk ka paraqitur formularin ESIG 025.*

Kompania "Genuis" sh.p.k ka paraqitur formularin ESIG 025 por ky formular nuk është as i firmosur dhe as i vulosur. Për këtë arsye i jepet të drejtë ankimesit.

- 3. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet se kompania "Genuis" sh.p.k nuk përmbush kriterin teknik 1.2 në lidhje me ISE modul Na, K, Cl*

Në bazë të katalogut kompania "Genuis" sh.p.k e përmbush këtë kriter.

- 4. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet se kompania "Genuis" sh.p.k nuk përmbush kriterin teknik me pajisjen që ofron dhe ka më pak se 50 pozicione për reagent.*

Në bazë të katalogut dhe të dhënave të paraqitura nga kompania "Genuis" sh.p.k pajisja ka më tepër se 50 pozicione për reagent por nuk përmbush kriterin ku 40 prej të cilave të jenë të fiksuara.

Për kompaninë "Fedos" sh.p.k

- 1. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet tuaja se kompania "Fedos" sh.p.k nuk zotëron autorizim nga Ministria e Shëndetësisë.*

Kompania "Fedos" sh.p.k zotëron autorizim nga Ministria e Shëndetësisë dhe është verifikuar.

- 2. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet tuaja se kompania "Fedos" sh.p.k nuk ka vërtetim për xhiron mesatare të tre viteve të fundit.*

Kompania Fedos e ka në dokumentat e saj vërtetimin për xhiron mesatare të tre viteve të fundit

- 3. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet tuaja se kompanisë "Fedos" sh.p.k i mungojnë kontratat e ngjashme në lidhje me tregtimin, suportin, mirëmbajtjen dhe garancinë e autoanalizatorit biokimik.*

Kompania Fedos nuk ka kontrata të ngjashme dhe i jepet te drejtë ankimesit.

- 4. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet se kompania "Fedos" sh.p.k nuk ka në stafin e tij inxhinierë që duhet të suportojë dhe mirëmbajë pajisjen e ofruar.*

Kompania Fedos nuk ka inxhinierë të trajnuar dhe të certifikuar për të suportuar dhe mirëmbajtur pajisjen e ofruar. Për këtë arsye i jepet të drejtë ankimesit.

5. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet tuaja se kompania “Fedos” sh.p.k nuk ka paraqitur formularin ESIG 025.

Ky pretendim nuk qëndron dhe gjithcka është konform ligjit dhe DST.

6. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet tuaja se kompania “Fedos” sh.p.k nuk përmbush kriterin 1.2 në lidhje me ISE modul Na, K, Cl.

Ky pretendim nuk qëndron dhe gjithcka është konform ligjit dhe DST.

7. Në lidhje me pretendimet dhe dyshimet tuaja se kompania “Fedos” sh.p.k ka bërë një ofertë ekonomike anomalisht të ulët.

Kompania Fedos ka bërë një ofertë anomalisht të ulët dhe i jepet të drejtë ankimesit.

Për kompaninë “Farma Net” sh.p.k

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se gjendja faktike e kompanisë “Farma Net” sh.p.k nuk do të ndryshojë duke qënë i skualifikuar dhe duke qënë se nuk është regjistruar ndonjë ankim nga kompania Frama net sh.p.k.”

II.5.2. Në datën 12.06.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke ngritur pretendime për shoqëritë “Genuis” sh.p.k, “Fedos” sh.p.k dhe “OES Distrimed” sh.p.k. Sipas ankimesit, megjithëse autoriteti kontraktor i ka dhënë të drejtë, nuk e shpalli fitues shoqërinë ankimese.

II.6. Në datën 24.06.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1063/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 641 prot., datë 20.06.2019, bashkëngjitur dokumentacioni i autoritetit kontraktor mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimes.

II.7. Në datën 22.07.2019 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin KPP 476/2019 ku vendosi si më poshtë vijon:

- 1. Të mos marrë në shqyrtim ankesat e operatorëve ekonomikë “O.E.S. Distrimed” sh.p.k, “Fedos” sh.p.k dhe “Biomedica Albania Distribution” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-17552-04-11-2019, me objekt: “Blerje Autonalizator Biokimik”, me fond limit 3 000 000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 16.05.2019 nga autoriteti kontraktor Qendra Shendetësore e Specialiteteve nr. 1.*
- 2. Autoriteti kontraktor të bëjë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE, sipas vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, si dhe të respektojë afatet e ankimit në zbatim të nenit 63 të LPP-së.*
- 3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “O.E.S. Distrimed” sh.p.k, “Fedos” sh.p.k dhe “Biomedica Albania Distribution” sh.p.k.*

5. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

II.8. Në datën 31.07.2019 autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE si më poshtë vijon:

1. “O.E.S. Distrimed” sh.p.k	1.298.750 lekë, skualifikuar
2. “Fedos” sh.p.k	1.570.000 lekë, skualifikuar
3. “Genius” sh.p.k	1.980.000 lekë, skualifikuar
4. “Farma Net Albania” sh.p.k	2.850.000 lekë, skualifikuar
5. “Biomedica Albania Distribution ” sh.p.k	2.935.000 lekë, kualifikuar
6. “Krijon” sh.p.k	ska paraqitur ofertë

Ofertuesit ankimues janë njoftuar elektronikisht për arsyet e skualifikimit të tyre. Konkretisht: Shoqëria “Fedos” sh.p.k është njoftuar për arsyet e skualifikimit të tij si vijon:

*“Ne mbështetje të nenit 56 të ligjit nr 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurim Publik” si edhe në zbatim të VKM nr 914, Datë 29.12.2014 kreu VII neni 66 pika 5, Komisioni i Shqyrtimit të ankesave verifikoi nëse oferta është anomalisht e ulët, u llogarit formula për oferte anomalishte të ulet nga ku rezultoj se oferta e FEDOS SHPK ka oferte aomalisht të ulet, perkatesisht $(1298750 + 1570\ 000 + 1980000 + 2850000 + 2935000 = 10\ 633\ 750 / 5 \text{ (operatore)} = 2\ 126\ 750 * 85\ \% = 1819\ 012.5$*

2.1.Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese Certifikaten CE Full Quality Assurance System të prodhuesit sipas Direktivave 93/42/EEC dhe klasifikimit të Keshillit të Europes, të prodhuesit, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave. Certifikata duhet nga organet certifikuese nderkombetare dhe të jete per secilin artikull specifik të ofruar në kete procedure prokurimi.

Pra, nga ana juaj nuk është paraqitur asnjë certifikatë me këto specifika.

2.2 Operatori duhet të paraqese katalog ose broshurë me të dhënat teknike për pajisjet e ofertuara, të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Në katalog të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secila nga pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar, si dhe të markohen specifikimet perkatese sipas të dhënave në DST.

Katalogu i paraqitur nga ana juaj ishte në anglisht dhe jo e perkthyer në gjuhën shqipe të kerkuar nga ana jone, gjithashtu dhe e paqarte pasi ishte e me germa jashtazakonisht të vogla duke na e bërë leximin pothuajse të pamundur.

2.3. Sigurimin e ofertes (nëse është e zbatueshme) sipas shtojcës 4, kjo e dhënë nuk është paraqitur nga kompania juaj

2.4 Eshtë rishikuar dhe investiguar mbi kontratën tuaj të ngjashme dhe konkretisht kapacitetet teknike pika 2.3.1. Nga konstatimet tona në dokumentacionin e tenderit gjendet

-Kontarta e furnizimeve dt 27.11.2018 me Spitalin Rajonal Lezhe me objekt Furnizim vendosje Pajisje Mjekesore për Spitalin Lezhe kua janë ofruar Monitor Pacienti, ECG, Nebulizator në vlerën 2,400,000 Pa TVSH.

-Kontrata Dt 23/06/2018 me Qendren Shendetesore të Specialiteteve nr 2 Tirane ,Nr 129 Prot me objekt Blerje Aparature Mjekesore për shërbimin e Fizioterapise në vlerën 5,008,800 me Tvsh.

Kontrata "Kontrata e Furnizimit me Spitalin Rajonal Lezhe" date 27.11.2018 ne vlere 2,400.000 pa TVSH nuk permbush kriterin per deshmi per furnizime te meparshme,te ngjashme duke qene se Monitor dhe Nebulizator jane pajisje Spitalore pa ngjashmeri me AUTOANALIZATORIN BIODIAGNOSTIK per laboratorin e institucionit Tone.

Kontrata e dt 23/06/2018 me Qendren Shendetesore e Specialiteteve nr 2 Tirane nr 129 prot me Objekt "Blerje Aparature Mjeksore" per Sherbiminn e Fizioterapise ne vleren 5,008,800 me Tvsh nuk konsiderohen si deshmi per furnizime te meparshme,te ngjashme me Autoanalizator Biokimik per laboratorin e institucionit tone.

Per kete arsye mospermbushja e kapacitetit Teknik pika 2.3.1 qendron dhe eshte i drejte. Ky kriter eshte i pa permbushur nga kompania sipas DST

3. Komisioni i shqyrtimit te ankesave gjithashtu shqyrtoi dhe dokumentacionin e specifikimeve teknike kur vuri re mungese ne pikat:

3.1 Pajisja realizonte ftohje 24 ore por ne temperature 5-15 c, jo ne temp 2-12 c te kerkuar nga ana jone

3.2 Leximi i absorvances nuk fillon 0.0

3.3 Konsumi i ujit jo me shume se 4 l/ore ($\leq 4L/ore$), nuk ekziston kjo e dhene ne kataologun e paraqitur nga ana juaj.

3.4 Nuk kishte te dhena qe pajisja ishte prodhim i dy viteve te fundit (2017-2018)

3.5 Te kete 40 kyeveta shumeperdorimshe, eshte e vertete qe ju ofroni 3 fishin por jo shumeperdorimshe.

3.6 Larje automatike te kyevetave, nuk ekziston kjo e dhene ne katalogun e paraqitur nga ana juaj.

4. Eshte rishikuar dhe investiguar mbi mos plotesimin e kriterit 7.3 ku kerkohet qe kompania te kete staf te trajnuar per pajisjen i cili eshte objekt prokurimi te shoqeruar me certificate.

KSHA konstatoi se ne dokumentat e dorezuar nga kompania FEDOS shpk ekzistojne si me poshte:

Per Inxhinjerin Orion Struga

-Vertetim nga Kompania SEAC/RADIM per njohurite nga trajnimi per aparat gjaku GENIUS,Fotometer SLIM,KOAGULOMETER CLOT 2, ELISA SIRIO

- Certificate per trajnim ne inxhinjeri klinike ne Suedi per kujdesin Shendetesore

-Certificate Pjesmarrje ne Konferencen nga RADOX

-Certificate Trajnimi per Sterilizator Avulli te firmes MATACHANA Spain

-Certificate per njohurite per pajisje e SEAC/ RADIM

-Vertetim qe ka kaluar me sukses kursin Sistemet X- RAY nga Akademia e sistemeve mjeksore Philips

-Certificate per pajisjet Utrasound

-Certificate Pjesemarrje per monitorimin e pacientit

-Certificate Trajnimi per pajisjet Hemodialize DIADVANCE dhe DIALIFE

KSHA nuk gjeti asnje certificate trajnimi per mirembajtjen dhe suportin e Pajisjes CS-300 B apo serie te kesaj kategorie pajisjesh te prodhuar nga kompania Kineze DIRUI. Duke qene se ky kriter eshte esencial per kete procedure dhe per garantimin e suportit,mirembajtjes dhe mire funksionimin te AUTOANALIZATORIT BIODIAGNOSTIK ,e konsiderojme kete kriter te pa permbushur nga kompania juaj.

Shoqëria "OES Distrimed" sh.p.k është njoftuar për arsyet e skualifikimit të tij si vijon:

Operatori ekonomik nuk i ka te gjitha specifikimet teknike dhe kriteret e pergjithshme te parashikuara ne DST si me poshte:

2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Certifikaten CE Full Quality Assurance System te prodhuesit sipas Direktivave 93/42/EEC dhe klasifikimit te Keshillit te Europes, te prodhuesit, origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara te vlefshme ne momentin e hapjes dhe dorezimit te ofertave. Certifikata duhet nga organet certifikuese nderkombetare dhe te jete per secilin artikull specifik te ofruar ne kete procedure prokurimi.

Pra, Kompania juaj ka paraqit nje certifikate sipas direktivave 98/79 EEC jo sipas direktivave 93/42/EEC te kerkuara nga ana jone

2.2 Kopje te vertetuar nga Organet Tatimore te listpageses se Sigurimeve shoqerore te gjeneruar nga sistemi elektronik i tatimeve per peiudhen Shkurt 2018-Shkurt 2019. KSHA konstatoj se kompania juaj ka paraqitur formularet ESIG025 ku inxhinjeri eshte i perfshire por asnje nga keto formular nuk eshte i vertetura nga Zyrat Tatimore me vule dhe firme te njome ose me ane te vules elektronike te gjeneruara nga tatimet.

Per kete arsye e konsiderojme kete kriter te pa permbushur nga kompania juaj sipas DST dhe kritereteve te kerkuara.

3. Eshte rishikuar dhe investiguar mbi kontraten tuaja te ngjashme dhe konkretish kapacitetet teknike pika 2.3.1

Nga konstatimet tona ne dokumentacionin e tenderit gjendet.

-Nje kontrate "Blerje pajisje Mjeksore dhe mobilimi per QSH Kamez date 18.04.2017 ne vleren 9,754,400 me fature tatimore date 11/05/2019 nr 225930307

- Date 1/08/2018 cell counter General Farma ft nr 225933799 ne 495,500 pa tvsh

-31/05/2018 ft nr 225933296 centrifug 390 euro pa Tvsh

-Fat date 31/10/2017 Genalb Farma nr 225931578 ne vleren 555,000 pa tvsh

-date 3/10/2018 fat nr 22593254 Coagulometer 1000 Euro pa tvsh

Kontrata 'Blerje Pajisje Mjeksore dhe mobilimi per QSH Kamez date 18.04.2017 ne vlere 9,754,400 nuk permbush kriterin per deshmi per furnizime te meparshme, te ngjashme duke qene se Aarat Grafie, Eko Kardinale dhe Gjinekologjike per laboratorin etj jane pajisje pa ngjashmeri me AUTOANALIZATOR BIODIAGNOSTIK per laboratorin e institucionit tone.

Faturat e paraqitura per Cell Counter, Pipeta, Mikser Rroller, Fotometer, Analizator urine, Centrifugat dhe Coagulometer nuk konsiderohen si deshmi per furnizime te meparshme, te ngjashme me AUTOANALIZATOR BIODIAGNOSTIK

4. Komisioni i shqyrtimit te ankesave gjithashtu shqyrtoi dhe dokumentacionin e specifikimeve teknike kur vuri re mungese ne pikat

4.1 Disku te permbaje jo me pak se 50 tuba analizash

KSHA konstatoi qe sipas katalogut te dorezuar nga ana juaj disku permbante 40 tuba analizash dhe jo 50 tuba sipas specifikimit teknik te kerkuar nga ana jone.

4.2 Leximi i absorbances nuk fillon nga 0.0

4.3 Metoda e analizes: endpoint, kinetike, Fixed-time, monokromatike/biokromatike, reagent kimike single/dual, turbidmetry, I teknologji zgjedhes te elektrodesh se joneve, fotometri absorbuese.

KSHA konstatoi se kjo e dhene nuk paraqitet ne katalogun origjinal te kompanise tuaj.

4.5 Te kete 40 kyeve te shumeperdorimshe

Katalogu i dorezuar nga Kompania juaj e permbante nr e kyevetave por jo shumeperdorimshe
4.6 Gjate periudhes se ankimimit ka ardhur nje ankese drejtuar ofertes tuaj nga Operatoret te tjere ekonomik me interes te drejperdrejte per kete procedure per te rishikuar dhe investiguar mbi mos plotesimin e kriterit 7.3 ku kerkohet qe kompania te kete staf te trajnuar per pajisjen i cili eshte objekt prokurimi te shoqeruar me certifikate.

KSHA kontatoj se ne dokumentat e dorezuara nga kompania O.E.S Distrimed shpk ekziston si me poshte:

-Kontrata me inxhinjerin Alban Prendi, CV dhe diploma plotesojne kriteret e tenderit.

-Gjithashtu kompania ka paraqi nje certifikate pjesmarrje nga data 27/11/2018 deri ne date 28/11/2019 ne kursin Biochemistry Anylyzer BS-240 te leshuar nga kompania Mindray .Certifikata e Pjesmarrjes nuk eshte certifikate trajnimi per suportin dhe mirembajtjen e pajisjes.

Per kete arsye e konsiderojme kete kriter te papermbushur nga kompania juaj.

Në mbështetje të nenit 56 të ligjit nr 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurim Publik” si edhe në zbatim të VKM nr 914, Datë 29.12.2014 kreu VII neni 66 pika 5, Komisioni Shyrtimit te ankesave verifikoi nëse oferta është anomalisht e ulët, u llogarit formula per oferte anomalishte te ulet nga ku rezultoj se oferta e O.E.S ka oferte anomalisht te ulet, perkatesisht $(1298750 + 1570\ 000 + 1980000 + 2850000 + 2935000 = 10\ 633\ 750 / 5 \text{ (operatore)} = 2\ 126\ 750 * 85 \% = 1\ 819\ 012.5$ Gjithashtu KSHA shyqrtoi dhe Argumentin tuaj ne lidhje me oferten per tenderin me objekt Blerje Autoanalizator Biokimik e protokulluar nga ana jone me nr 577 Prot date 1/06/2019 .Informacioni i paraqitur nga kompania juaj nuk e bindi KSHA qe pajisja me objek Autonalizator Biokimik mund ti plotesoj nevojat e Institucionit Tone. Gjithashtu kompania qe ju ka derguar pergjigjen nuk e ka perkthyer ne gjuhen shqipe te kerkuar sipas DST.

II.9. Në datën 06.08.2019 operatori ekonomi “Fedos” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

[...]

Lidhur me argumentin: “Ne mbështetje të nenit 56 të ligjit nr 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurim Publik” si edhe në zbatim të VKM nr 914, Datë 29.12.2014 kreu VII neni 66 pika 5, Komisioni i Shyrtimit te Ankesave verifikoi nëse oferta është anomalisht e ulët, u llogarit formula per oferte anomalishte te ulet nga ku rezultoi se oferta e FEDOS SHPK ka oferte aomalisht te ulet, perkatesisht $(1298750 + 1570\ 000 + 1980000 + 2850000 + 2935000 = 10\ 633\ 750 / 5 \text{ (operatore)} = 2\ 126\ 750 * 85 \% = 1819\ 012.5$ ”, theksojmë se nga ana e KVO-së nuk është kërkuar asnjë informacion me shkrim apo elektronikisht për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët në mënyrë që të bëjë vlerësimin e ofertës sonë.

Lidhur me argumentin e KVO-së “Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Certifikaten CE Full Quality Assurance System te prodhuesit sipas Direktivave 93/42/EEC dhe klasifikimit te Keshillit te Europes, te prodhuesit, origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara te vlefshme ne momentin e hapjes dhe dorezimit te ofertave. Certifikata duhet nga organet certifikuese nderkombetare dhe te jete per secilin artikull specifik te ofruar ne kete procedure prokurimi.”

KVO-ja del jashtë kontekstit dhe objektit të prokurimit, duke treguar një mosprofesionalizëm teknik të theksuar.

Pajisja që AK ka prokuruar sipas klasifikimit të Këshillit të Europës e shprehur dhe në DST bën pjesë në kategorizimin IVDD dhe certifikohet me standardet 98/79/ec. Direktiva e kërkuar nga KSHA 93/42/EEC nuk është objekt i këtij prokurimi dhe si i tillë nuk mund të jetë paraqitur nga asnjë operator pasi nuk ekziston për një pajisje laboratorike IVDD.

Lidhur me argumentin: “Operatori duhet të paraqesë katalog ose broshurë me të dhënat teknike për pajisjet e ofertuara, të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secila nga pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar, si dhe të markohen specifikimet perkatëse sipas të dhënave në DST.

Katalogu i paraqitur nga ana juaj ishte në anglisht dhe jo e perkthyer në gjuhën shqipe të kërkuar nga ana jone, gjithashtu dhe e paqarte pasi ishte e me gërma jashtëzakonisht të vogla duke na e bërë leximin pothuajse të pamundur.”

KSHA në mënyrë tendencioze dhe joprofesionale, po brenda pikës 3, deklaroi se nuk kemi paraqitur katalog në gjuhën shqipe dhe që katalogu në anglisht është me gërma jashtëzakonisht të vogla, duke e bërë leximin pothuajse të pamundur.

Fillimisht ju bëjmë me dije që në sistemin online të APP është ngarkuar dokumenti Katalogu_i_noterizuar.pdf, i cili është lehtësisht i lexueshëm. Ky dokument përmban katalogun e pajisjes dhe është i perkthyer me nr noterial 1854, datë 15.05.2019 nga perkthyesja znj. E.Vrenezi. Nga ana e shoqërisë “Fedos” sh.p.k, bashkëlidhur gjithë dokumentacionit të kërkuar, është paraqitur katalogu për artikujt objekt prokurimi të cilat janë të markuara me të verdhë. [...] Shoqëria “Fedos” sh.p.k ka bashkëlidhur katalogun anglisht dhe të perkthyer e të noterizuar në gjuhën shqipe të markuara me ngjyrë të verdhë në pjesët të cilat lidhen me produktin objekt prokurimi. Referuar kërkesave të DST për praninë të katalogut vetëm në mënyrë elektronike nuk është me nën përgjegjësinë tonë mënyra e printimit apo cilësia e printerit të zyrës përgjegjëse në AK. Është vetë KVO që në pikën 4 të përgjigjes së saj thotë që operatori nuk plotëson kërkesat teknike të pajisjes duke përmendur disa pika. Lind pyetja se ku është referuar KVO për të nxjerrë këto specifikime që mungojnë? Pra katalogu paska qënë në shqip dhe shumë mirë i lexueshëm nga KVO, përse kohë janë bërë krahasime të specifikimeve teknike për pikat e tjera të katalogut.

Lidhur me argumentin: Sigurimi i ofertes (nese eshte e zbatueshme) sipas shtojces 4, kjo e dhene nuk eshte paraqitur nga kompania juaj” theksojmë se:

Fillimisht KVO nuk është bazuar në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, i cili në nenin 18 “Sigurimi i ofertës” shtohet një fjali, me këtë përmbajtje: “Sigurimi i ofertës nuk kërkohet në procedurat e prokurimit me vlerë më të ulët se kufiri i lartë monetar”.

Pra ligji specifikon qartë që sigurimi i ofertës nuk duhet të kërkohet. Duke qënë se as në DST nuk kërkohet të jetë e zbatueshme kjo tregon qartë që vlerësimet e KVO nuk kanë pikë referimi DST apo LPP – kjo një paaftësi e qartë nga ana e KVO.

Lidhur me argumentin: “Eshtë kërkuar dhe investiguar mbi kontratën tuaja të ngjashme dhe konkretisht kapacitetet teknike pika 2.3.1. Nga konstatimet tona në dokumentacionin e tenderit gjendet -Kontrata e furnizimeve dt 27.11.2018 me Spitalin Rajonal Lezhe me objekt Furnizim vendosje Pajisje Mjekesore për Spitalin Lezhe ku janë ofruar Monitor Pacienti, ECG, Nebulizator në vlerën 2,400,000 Pa TVSH.

-Kontrata Dt 23/06/2018 me Qendren Shendetesore te Specialiteteve nr 2 Tirane ,Nr 129 Prot me objekt Blerje Aparature Mjeksore per sherbimin e Fizioterapise ne vleren 5,008,800 me Tvsh. Kontrata “Kontrata e Furnizimit me Spitalin Rajonal Lezhe” date 27.11.2018 ne vlere 2,400.000 pa TVSH nuk permbush kriterin per deshmi per furnizime te meparshme,te ngjashme duke qene se Monitor dhe Nebulizator jane pajisje Spitalore pa ngjashmeri me AUTOANALIZATORIN BIOKIMIK per laboratorin e institucionit Tone.”, theksojmë se nga ana e KVO-së janë kërkuar furnizime të ngjashme dhe kontratat që kemi paraqitur jemi bazuar në kërkesat e DST dhe specifikisht... furnizime të ngjashme dhe jo furnizime të njëjta. Të dyja kontratat janë pajisje mjekësore, pra pajisje të ngjashme me objektin e prokurimit dhe plotësojnë shumën e kërkuar. [...].

Lidhur me argumentin: “Komisioni i shqyrtimit te ankesa gjithashtu shqyrtoi dhe dokumentacionin e specifikimeve teknike kur vuri re mungese ne pikat:3.1 Pajisja realizonte ftohje 24 ore por ne temperature 5-15 c, jo ne temp 2-12 c te kerkuar nga ana jone.3.2 Leximi i absorvances nuk fillon 0.0.3.3 Konsumi i ujit jo me shume se 4 l/ore (<=4L/ore), nuk ekziston kjo e dhene ne kataologun e paraqitur nga ana juaj. 3.4 Nuk kishte te dhena qe pajisja ishte prodhim i dy viteve te fundit (2017-2018). 3.5 Te kete 40 kyevea shumepedorimshe, eshte e vertete qe ju ofroni 3 fishin por jo shumepedorimshe. 3.6 Larje automatike te kyevetave, nuk ekziston kjo e dhene ne katalogun e paraqitur nga ana juaj”, theksojmë:

-Në lidhje me pretendimet teknike të pikës 2.3 sqarojmë që specifikimi i përmendur ka të bëjë me reagentin dhe jo pajisjen. Reagentët për të cilët kërkohet pajisja janë biokimike dhe temperatura optimale është 8-12°C. Duke e parë në aspektin funksional intervali 5-15°C ofron qëndrueshmëri më të lartë dhe siguron mbarëvajtjen e analizave të AK tuaj.

-Në lidhje me pikën 2.5 KSHA nuk lexon/jep informacionin e saktë pasi në katalog është shumë qartë e theksuar që absorbanca është 0-3.3 Abs.

-Në lidhje me pikën 5.5 pajisja nuk mund të ketë një vlerë të saktë pasi kjo varet nga përdorimi ditor, numri i QC, Kalibrimeve etj. Ky specifikim nuk ndikon në objektin e kësaj blerje pasi është i papërfillshëm në lidhje me funksionin e pajisjes.

-Në lidhje me pikën 5.3 dhe 5.4 pasi janë të lidhura bashkë, KSHA sërish nuk jep informacionin e saktë pasi në katalog shkruhet shume qartë që pajisja bën larje dhe mbi të gjitha e ngroh vetë ujin dhe ky specifikim bën të qartë që kyvetat janë shumë përdorimshe dhe mbi të gjitha ku është kërkuar me diametër 5mm që e bën të pallogjikshëm ngritjen e këtij pretendimi. Pajisja nuk mund të ofrojë larjen e kyvetave njëpërdorimshe.

-Në lidhje me pikën 6.5, në rradhë të parë, kjo nuk është në kërkesat teknike të pajisjes dhe nuk është një informacion që mund të gjendet në katalogun e saj, por është si kërkesë më vete dhe për të cilën është lëshuar deklaratë nga OE Fedos. Në rradhë të dytë, një prodhues nuk mund të hamëndësojë kohën kur një autoritet diku në botë mund të bëjë blerje pasi katalogu mund të jetë i krijuar para vitit 2017 ose 2018 dhe nuk mund të shkruhet dicka që nuk është e vërtetë.

- Vlerësimi i ofertës bëhet nga KVO, ndërkohë që KVO në refuzimin e ofertës sonë shprehet: “KSHA gjithashtu shqyrtoi dhe dokumentacionin e specifikimeve teknike...”. Pra del dukshëm që KVO nuk bën një vlerësim oferte dhe është KSHA ajo që merr kompetencat e KVO.

Lidhur me argumentin se: “mos plotesimi i kriterit 7.3 ku kerkohet qe kompania te kete staf te trajnuar per pajisjen i cili eshte objekt prokurimi te shoqeruar me certificate.

KSHA konstatoi se ne dokumentat e dorezuar nga kompania FEDOS shpk ekzistojne si me poshte:

Per Inxhinjerin Orion Struga

-Vertetim nga Kompania SEAC/RADIM per njohurite nga trajnimi per aparat gjaku GENIUS, Fotometer SLIM,KOAGULOMETER CLOT 2, ELISA SIRIO

- Certifikate per trajnim ne inxhinjeri klinike ne Suedi per kujdesin Shendetesore

-Certifikate Pjesmarrje ne Konferencë nga RADOX

-Certifikate Trajnimi per Sterilizator Avulli te firmes MATACHANA Spain

-Certifikate per njohurite per pajisje e SEAC/ RADIM

-Vertetim qe ka kaluar me sukses kursin Sistemet X- RAY nga Akademia e sistemeve mjeksore Philips

-Certifikate per pajisjet Utrasound

-Certifikate Pjesemarrje per monitorimin e pacientit

-Certifikate Trajnimi per pajisjet Hemodialize DIADVANCE dhe DIALIFE

KSHA nuk gjeti asnje certifikate trajnimi per mirembajtjen dhe suportin e Pajisjes CS-300 B apo serie te kesaj kategorie pajisjesh te prodhuar nga kompania Kineze DIRUI. Duke qene se ky kriter eshte esencial per kete procedure dhe per garantimin e suportit,mirembajtjes dhe mire funksionimin te AUTOANALIZATORIT BOKIMIK,e konsiderojme kete kriter te pa permbushur nga kompania juaj.”

Në lidhje me inxhinierët ju sqarojmë që fillimisht KVO bën verifikim dhe vlerëson duke mos u bazuar në dokumentat shoqëruese të ofertës së paraqitur në faqen e APP për këtë procedurë prokurimi. Në APP janë ngarkuar 2 dokumenta me emërtimet Eng.O.Struga dhe Eng. L. Peci dhe KVO sërisht bën vlerësim të pjesshëm, duke u marrë me aludimet e operatorëve të tjerë dhe jo me atë cfarë OE Fedos ka paraqitur në këtë procedurë.

Vetë KSHA ka nxjerrë listën e trajnimeve të Eng.O.Struga dhe sic kërkohet në DST është i trajnuar për pajisjen objekt i këtij prokurimi, Autoanalizator Biokimik. Firmat si SEAC/RADIM apo RADOX janë prodhues global të mirënjohur për këtë kategori pajisjesh dhe ky fakt e bën të pavërtetë pretendimin e KSHA.

Bëjmë me dije që të dy inxhinierët e Fedos sh.p.k janë me status Inxhinier Klinik me një eksperiencë përkatësisht 19 dhe 5 vjecare, pikërisht në fushën e inxhinierisë mjekësore. OE Fedos ka në mirëmbajtje të vazhdueshme prej disa vitesh autoanalizatorin aktual të instaluar në laboratorin e AK. Duke qënë se ky kriter është esencial për KSHA, OE Fedos i ka ofruar të gjitha mundësitë si në burime njerëzore maksimale për të garantuar instalimin me sukses, trajnimin nga ana teknike dhe klinike po ashtu dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Vetë AK juaj mund ta vërtetojë këtë, pa pasur nevojë për ankesa apo aludime nga operatorë të tjerë konkurrentë. [...].

Nga ana teknike po ju theksojmë se pajisja e ofruar nga ne kryen 300 teste në orë dhe që i bie 50% më shumë nga cfarë është kërkuar. Konkretisht 300 teste në orë nga 200 cfarë kërkohet. Kërkohen 380 teste me ISE, ne ofrojmë 450. Kërkohen të paktën 50 vende për mostra, ne ofrojmë 115. Kërkohen 50 pozicione për reagentët , ne ofertojmë 67. Kërkohen 40 kyveta ndërsa ne ofertojmë 3 fishin, 120 kyveta. Kërkohen 8 filtra ne ofertojmë 12 filtra. Kërkohet funksioni STAT po ashtu i ofertuar nga ne. Duket qartë që KVO as nuk ka marrë mundimin të shkarkojë dhe të lexojë dokumentacionin e dorëzuar nga ne. Bazuar në kërkesat ligjore oferta e shoqërisë sonë plotëson 100% specifikimet teknike dhe i tejkalon ato duke favorizuar fluksin në rritje të Qendrës Shëndetësore të Specialitetetve Nr. 1 dhe urgjencat kombëtare.”

II.9.1. Nëpërmjet shkresës nr.793/1 prot., datë 13.08.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, si më poshtë vijon:

1-Ne lidhje me pretendimin e pare, KSHA pasi shqyrtoi DST, ofertat e paraqitura, Vendimin e KSHA se pare ngritur me urdherin nr 51 date 28.05.2019 si dhe argumentimin e OE FEDOS Shpk konstaton se ne baze te nenit 56 te VKM "Per rregullat e Prokurimit Publik ", verifikimi per ofertat anomalisht te ulet behet vetem per ofertat e vlefshme, pra te kualifikuara. Pasi shqyrtoam argumentat vleresojme se oferta e paraqitur nga OE nuk mund te verifikohej per oferte me cmim anomalisht te ulet nga KVO, apo/dhe KSHA e pare, persa kohe, nga te dyja komisionet oferta nuk eshte kualifikuar si e vlefshme. Sa me siper, KSHA e dyte ngritur me urdherin nr 69 date 06.08.2019 nuk mund te konstatojë nese oferta juaj eshte anomalisht e ulet, pasi si nga dy vleresimet e meparshme ashtu edhe nga vleresimi yne, ku sic kemi permendur me siper operatori ekonomik OES Distrimed nuk permbush kriterin per tu kualifikuar. Per pasoje, duke qene se oferta juaj nuk konstatohet e vlefshme nuk mund te jete subjekt i verifikimit per cmim anomalisht te ulet.

2- Ne lidhje me sqarimin e OE Fedos Shpk, te dhene per pretendimin e dyte, KSHA pasi verifikoi pretendimin tuaj, konstaton se pretendimi juaj, persa i perket kesaj pike, qendron.

3-Ne lidhje me pretendimin e trete, sqarojme se: KVO dhe KSHA se pare i eshte vene ne dispozicion materiali i printuar jo ne forme elektronike dhe pasi KSHA e Dyte verifikoi pretendimin tuaj, konstaton se pretendimi juaj, persa i perket kesaj pike, qendron

4-Ne lidhje me pretendimin e katert, bazuar ne vendimin nr 914 date 29.12.2019 per miratimin e rregullave te prokurimit publik i cili ne nenin 18, pika 1 i ndryshuar me Vendimin Nr 797, date 29.12.2017 "Sigurimi i ofertes nuk kerkohet ne procedurat e prokurimit me vlere me te ulet se kufiri i larte monetar ", KSHA konstatoi se pretendimi juaj , persa i perket kesaj pike, qendron dhe i jep te drejte Operatorit Ekonomik Fedos Shpk

5-Ne lidhje me pretendimin e peste, KSHA shqyrtoi kontratat e paraqitur nga ana juaj dhe doli ne konkluzionin se :

Kontratat e paraqitura nga kompania Fedos Shpk nuk konsiderohen si deshmi per furnizime te meparshme,te ngjashme me Autoanalizator Biokimik per laboratorin e institucionit tone.

Kontrata e furnizimeve dt 27.11.2018 me Spitalin Rajonal Lezhe me objekt Furnizim vendosje Pajisje Mjekesore per Spitalin Lezhe ku jane ofruar Monitor Pacienti, ECG, Nebulizator ne vleren 2,400,000 Pa TVSH, Kontrata Dt 23/06/2018 me Qendren Shendetesore te Specialiteteve nr 2 Tirane ,Nr 129 Prot me objekt Blerje Aparature Mjekesore per sherbimin e Fizioterapise ne vleren 5,008,800 me Tvsh KSHA e rrezon pretendimin tuaj.

6-Ne lidhje me pretendimin e gjashte, KSHA pasi verifikoi pretendimin tuaj dhe shqyrtoi dokumentat e paraqitur nga ana juaj ne lidhje me specifikimet teknike konkludoi se ne lidhje me piken 2.3 paisja te realizoje ftohje 24 ore te perhershme per diskun e reagenteve ne temperature 2-12 c nga ana juaj eshte paraqitur me temperature 5-15 c. KSHA e rrezon pretendimin tuaj.

Ne lidhje me piken 2.5 leximi i adsorbances te filloje nga 0.0 KSHA konstaton se, pretendimi juaj persa i perket kesaj pike qendron.

Ne lidhje me piken 5.5 konsumi uji jo me shume se 4L/ore. KSHA vlereson se OE, Fedos Shpk nuk e permbush kete pike.Ne lidhje me piken 5.3 dhe 5.4 Te kete 40 kyeveta shumeperdorimshe dhe larje

automatike te kyevetave KSHA gjykon qe mund te jene shume perdorimshe edhe pse nuk eshte qartesisht e verifikueshme. KSHA i jep te drejte OE ne kete pike.

Ne lidhje me piken 6.5 Prodhimi i dy viteve te fundit (2017-2018) KSHA verifikoi pretendimin tuaj, konstaton se pretendimi juaj, persa i perket kesaj pike, qendron.

7-Ne lidhje me pretendimin e shtate, KSHA konstatoi se ne dokumentat e dorezuar nga kompania FEDOS shpk ekzistojne si me poshte: Per Inxhinjerin Orion Struga

-Vertetim nga Kompania SEAC/RADIM per njohurite nga trajnimi per aparat gjaku GENIUS, Fotometer SLIM,KOAGULOMETER CLOT 2, ELISA SIRIO

- Certifikate per trajnim ne inxhinjeri klinike ne Suedi per kujdesin Shendetesore

-Certifikate Pjesmarrje ne Konfernce nga RADOX

-Certifikate Trajnimi per Sterilizator Avulli te firmes MATACHANA Spain

-Certifikate per njohurite per pajisje e SEAC/ RADIM

-Vertetim qe ka kaluar me sukses kursin Sistemet X- RAY nga Akademia e sistemeve mjeksore Philips

-Certifikate per pajisjet Utrasound

-Certifikate Pjesemarrje per monitorimin e pacientit

-Certifikate Trajnimi per pajisjet Hemodialize DIADVANCE dhe DIALIFE

KSHA nuk gjeti asnje certifikate trajnimi per mirembajtjen dhe suportin e Pajisjes CS-300 B apo serie te kesaj kategorie pajisjesh te prodhuar nga kompania Kineze DIRUI. Duke qene se ky kriter eshte esencial per kete procedure dhe per garantimin e suportit, mirembajtjes dhe mire funksionimin te AUTOANALIZATORIT BIODIAGNOSTIK ,e konsiderojme kete kriter te pa permbushur nga kompania juaj.

Ne baze te konstatimeve te siperpermdura, KSHA le ne fuqi vendimin e skualifikimit te Operatorit Ekonomik FEDOS Shpk.

II.9.2. Në datën 20.08.2019 operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij.

II.10. Në datën 06.08.2019 operatori ekonomik “OES Distrimed” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

“Në lidhje me pretendimin I- Sqarojmë se kemi paraqitur certifikatë CE sipas klasifikimit të Këshillit të Europës direktiva 98/79/EC për pajisjet laboratorike. Kjo vërteton qëllimin për të cilën është vendosur ky kriter që pajisja të ketë CE. AK ka vepruar në mënyrë të njëanshme pasi të gjithë OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur certifikatë të së njëjtës direktivë CE (ose kanë paraqitur Certifikatë 93/42/EC por që nuk ka në objektin e saj pajisjen laboratorike, objekt i kësaj procedure), pasi pajisjet laboratorike sipas Këshillit të Europës klasifikohen tek direktiva IVDD 98/79/EC. Vetë kërkesa 2.3.4. e citon ndër të tjera: ... “dhe klasifikimit të Këshillit të Europës”. Pra certifikata e paraqitur nga OES Distrimed sh.p.k në këtë procedurë prokurimi është sipas klasifikimit të Këshillit të Europës për pajisjet laboratorike dhe sipas kërkesave të DST.

Në lidhje me pretendimin II- Sqarojmë se listpagesat e paraqitura janë me vulë elektronike (bar kod) nga sistemi i tatimeve dhe autenticiteti është lehtësisht i verifikueshëm. AK, në bazë të ligjit për prokurimet publike rezervon të drejtën të verifikojë çdo dokument të paraqitur në SPE dhe aq më tepër kur një dokument është i lëshuar nga Institucionet Shqiptare verifikimi është edhe më i lehtë.

Në pretendimin tuaj ju shtoni arsye të cilat nuk janë të kërkuara në DST “... me vulë dhe më firmë të njomë ose me anë të vulës elektroniketë gjeneruara nga tatimet, ky tog-fjalësh nuk është në asnjë pjesë të kriterëve dhe pavarësisht këtij fakti, po ju konfirmojmë përsëri se dokumenti i paraqitur nga aan jonë në SPE është me vulë elektronike sic edhe vetë e citoni.

Në lidhje me pretendimin III- Sqarojmë se kemi paraqitur furnizime të ngjashme për pajisjet laboratorike, duke plotësuar kriterin 2.3.1 në vlerën 40% të fondit limit dhe duke e tejkeluar atë. Të gjitha pajisjet e përmendura nga KSHA “Cell Counter, Pipeta, Mikser Rroller, Fotometer, Analizatore urine, Centrifugat dhe Coagulometer” janë pajisje laboratorike të njëjta me objektin e kësaj procedure Autoanalizator Biokimik, e cila është pajisje laboratorike, në mesin e pajisjeve të cituara është edhe pajisja Fotometer e cila është pajisje identike me pajisjen e kërkuar në këtë procedurë “Chemistry Analyzer”. Në nenin 78 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, pika 6 (a) është cituar Titullari i Autoritetit Kontraktor ia ngarkon cështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, i cili duhet të jepte interpretimin e saktë se “Fotometër” është një emërtim tjetër alternative për “Autoanalizator Biokimik”, i përdorur gjësisht në Shqipëri. Në lidhje me mosplotësimin e “Furnizimeve të ngjashme”, sjellim në vëmendjen tuaj se kërkesa në DST për kapacitetin teknik, pikë 2.3.1. citon: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të fondit të vënë në dispozicion...”. Qartësisht nuk është kërkuar furnizime identike të pajisjes për “Autoanalizator Biokimik”, por të ngjashme, që do të thotë pajisje të së njëjtës natyrë, pra pajisje laboratorike. Sa më sipër, sipas dokumentacionit të dorëzuar në SPE, konfirmojmë që plotësojmë kriterin mbi “Furnizime të ngjashme” në vlerën 40% të fondit limit vetëm me pajisjet laboratorike, pa marrë në konsideratë pajisjet e tjera. Bashkëngjitur kësaj ankese mund të gjeni faturat e shitjeve të pajisjeve laboratorike.

Në lidhje me pretendimin IV- Sqarojmë se pajisja e ofruar nga ne e plotëson këtë specifikim.

Në katalogun original të pajisjes faqe 2 (ose katalogu i përkthyer në faqet 3 dhe 5) thuhet konkretisht: Deri në 80 pozicione kampionesh (tuba analizash)

Deri në 80 pozicione reagentësh (shishe reagentësh)

40 fikse dhe 40 të shkëmbyeshme

Përsa më sipër, kapaciteti maksimal i diskut është që të mbajë 80 tuba analizash. Kjo pasi disku ka kapacitet që të mbajë 40 pozicione fikse për tuba analizash, 40 pozicione fikse për shishe reagentësh dhe 40 pozicione të konvertueshme/shkëmbyeshme ndërmjet shisheve të reagentëve dhe tubave të analizave. Kjo lehtësisht e verifikueshme edhe në figurën e paraqitur të diskut në katalog faqe 2, ku në pozicionet 1 dhe 2 të rrjeshtit të mesëm të diskut janë vendosur tuba analizash për të vërtetuar shkëmbimin ndërmjet tubave/shisheve në këtë rrjesht me 40 pozicione. Pra pajisja mund të përdoret me një konfigurim 50 (40+10) pozicione për tuba analizash dhe 70 (40+30) pozicione për shishe analizash duke plotësuar specifikimin e kërkuar më sipër.

Pra specifikimi i mësipërm plotësohet 100%.

Në lidhje me pretendimin V- Sqarojmë se specifikimi në fjalë plotësohet 100% nga pajisja e ofruar nga ne. Në katalogun origjinal të pajisjes, faqe 8, (ose katalogu i përkthyer në faqet 9 dhe 17) citohet konkretisht: Diapazoni Absorbimit: 0-4.0 Abs (konvertim 10 mm), rezolucioni 0.0001 Abs. Pra është lehtësisht e verifikueshme që leximi i absorbancës fillon në 0.0.

Në lidhje me pretendimin VI- Sqarojmë se specifikimi në fjalë plotësohet 100% nga pajisja e ofruar nga ne. Në katalogun origjinal të pajisjes faqe 8 (ose katalogu i përkthyer në faqet 9 dhe 17) thuhet konkretisht: Parimet e matjes: Absorbance fotometrike, turbimetri, teknologji zgjedhese të elektrodës së joneve. Metodologjia: endpoint, Fixed-time, kinetike, ISE opsionale, reagent kimik single/duale, monokromatike, bi-kromatike.

Pra specifikimi i mësipërm plotësohet 100% nga pajisja e ofruar në këtë procedurë prokurimi.

Në lidhje me pikën VII- Sqarojmë se specifikimi plotësohet 100% nga pajisja e ofruar nga ne.

Në katalogun original të pajisjes faqe 8 (ose katalogu i përkthyer në faqen 9 dhe 17) thuhet konkretisht: Rotori i reaksionit: mbajtëse rrotulluese mban 40 kyveta

Kyveta: shumëpërdorimshme, gjatësia optike 5 mm.

Specifikimi i këkuar ofrohet dhe plotësohet 100% nga pajisja e ofruar.

Në lidhje me pikën VIII - Sqarojmë se kemi paraqitur certifikatën e trajnimit të lëshuar nga prodhuesi për pajisjen e ofruar në këtë procedurë prokurimi, modeli BS-240. Certifikata ka objekt: Technical Training 2018/11/27-2018/11/28 (Trajnim Teknik 27/11/2018-28/11/2018) me vlefshmëri 2 vjecare.

Në asnjë vend të DT nuk është kërkuar që certifikata të ketë të përshkruar fjalë specifike si p.sh “support”. Megjithatë për t’ju ardhur në ndihmë vlerësimin tuaj sa më objektiv, ju bëjmë me dije se trajnimi teknik përfshin instalimin, mirëmbajtjen, riparimin, asistencën teknike dhe trajnim mbi përdorimin. Logjikisht një certifikatë trajnimi teknik është një dokument që vërteton se inxhinieri është trajnuar dhe është i aftë të instalojë, mirëmbajë, riparojë, asistojë dhe trajnojë persona të tjerë. Jo domosdoshmërisht cdo fjalë si “support” mund të përdoret në certifikatë.

Në lidhje me pretendimin IX- Sqarojmë se KSHA, në kundërshtim me nenin 56 të LPP, Rregullat e Prokurimit Publik, aplikon në mënyrë të gabuar formulën për ofertat anomalisht të ulta. Kjo formulë zbatohet vetëm mbi ofertat e kualifikuara, ndërkohë që sipas AK oferta jonë është skualifikuar. KSHA ka patur detyrimin ligjor që në zbatim të rekomandimeve të KPP-së të vlerësojë procedurën dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjore mbi vlerësimin e rregullt të ofertave të paraqitura për këtë procedurë prokurimi. Përsa kohë oferta jonë është e skualifikuar, përfshirja e saj në formulën e llogaritjes së ofertave anomalisht të ulëta, është në kundërshtim me dispozitat ligjor etë LPP-së si dhe rekomandimeve të fundit të KPP-së. ... Autoriteti kontraktor vlerëson së pari dokumentacionin administrative-ligjor të paraqitur në tender nga ofertuesit, për të përcaktuar ofertat e vlefshme. Aplikimi i formulës për ofertat anomalisht të ulëta bëhet vetëm mbi ofertat e vlefshme. Në këto kushte, nuk kuptojmë sesi nga ana juaj është arritur në përfundimin se oferta jonë është anomalisht e ulët, duke qënë se keni pretenduar mospërmbushje të kriterëve të pranimit dhe specifikimeve teknike. Sjellim në vëmendje se oferta jonë nuk ka qënë e kualifikuar në asnjë moment dhe si rrjedhojë të gjitha hapat e AK duke e cilësuar ofertën tonë si anomalisht të ulët janë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Përvec sa më sipër, referuar nenit 56 të LPP-së, edhe në rastet kur një ofertë rezulton anomalisht e ulët, autoriteti kontraktor ka detyrimin të kërkojë sqarime me shkrim nga ofertuesi, mbi anën ekonomike të ofertës së paraqitur dhe nuk mund të skualifikojë automatikisht këtë ofertë, sikurse është vepruar nga ana juaj.

Pavarësisht këtij fakti, në argumentimin e ofertës sonë të hartuar në gjuhën shqipe (bashkëlidhur kësaj ankese) janë dhënë të gjithë elementët e ofertës sonë dhe konkretisht si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi	Prodhuesi	Vlera (USD)	Kursi Këmbimit	Vlera (lek)
1	Cmimi blerjes pajisjes	Mindray	7800	110 lekë	858.000
2	Reagente për 5000 analiza	Mindray	500	110 lekë	55.000
3	Transporti ndërkombëtar me ajër + shpenzime të tjera (transfera bankare, shpenzime doganore, regjistrim, transport local, instalim etj.)	Skynet	1300	110 lekë	143.000
4	Fitimi				242.750
5	Oferta				1.298.750

Pra është dhënë e detajuar e gjithë vlera e ofertës sonë që nga cmimi i dhënë nga prodhuesi e deri në realizimin final. Për të argumentuar këtë është paraqitur edhe komunikimi me email nga prodhuesi mbi ofertën e dhënë për këtë tender ku mund të verifikohet cdo dyshim që mund të ketë autoriteti juaj kontraktor.

Duke e vlerësuar motivimin e autoritetit tuaj kontraktor për të investiguar ofertat e kësaj procedurë prokurimi mbi kërkesat e kompanisë “Biomedica Albania Distribution” sh.p.k si dhe në zbatim të LPP mbi trajtimin e barabartë të OE si dhe mosdiskriminimin, edhe kompania jonë duke patur interes të drejtpërdrejtë në këtë procedurë prokurimi, ngre dyshime të forta mbi plotësimin e kriterëve të vecanta nga kjo kompani dhe më konkretisht mbi kapacitetin teknik pika 2.3.4. ku kërkohet: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën CE Full Quality Assurance System të prodhuesit sipas Direktivave 93/42/EEC dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, të prodhuesit, origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave. Certifikata duhet nga organet certifikuese ndërkombëtare dhe të jetë për secilin artikull specifik të ofrur në këtë procedurë prokurimi”. Sa më sipër kërkohet të verifikohet Direktiva e Certifikatës CE e paraqitur nga Kompania “Biomedica Albania Distribution” sh.p.k si dhe të verifikohet objekti i certifikatës së paraqitur nëse pajisja objekt prokurimi është e përfshirë.

II.10.1. Nëpërmjet shkresës nr.792/1 prot., datë 13.08.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si vijon:

1-Ne lidhje me sqarimin e OE, te dhene per pretendimin ne paragrafin e fundit (pika1) faqa 5, KSHA pasi verifikoi pretendimin tuaj, konstaton se pretendimi juaj, persa i perket kesaj pike, qendron.

Per sa me siper KSHA ne lidhje me kete pike e pranon ankesen e OE

2- Ne lidhje me sqarimin e OE, te dhene per pretendimin 2, ne paragrafin 2, faqa 6, KSHA pasi shqyrtoi DST, ankesen tuaj si dhe vlerësimin e KVO sqaron si me poshte:

Ligji i prokurimit publik, VKM perkatese si dhe Dokumentat Standarde te Tenderit, kane percaktuar jo vetem kriteret minimale te kualifikimit te cilat vertetojne aftesine teknike, ekonomike, por edhe formen e paraqitjes se dokumentacionit te kerkuar, i cili perben shkak per skualifikim, nese nuk

paraqitet sipas formes se kerkuar, duke bere keshtu te mundur qe te ruhen parimet e konkurences se ndershme dhe te lire midis operatoreve konkurues. Nese ndonje prej kriterëve te vendosura ne DST, vleresohet se nuk eshte ne proporcion me objektin e prokurimit, apo ndonje nga elementet formal te kerkuar nga AK ne DST, nuk eshte i justifikueshem, cdo pale e interesuar ka nje afat 7 ditor, qe prej publikimit te njoftimit te kontrates per ti kerkuar AK ndryshimin e DST. Per kete pike, pra persa i perket formes me te cilen kerkohet paraqitja e dokumentit justifikues per numrin e punonjesve, nuk rezulton te jete bere nga ju dhe/apo pale tjetër e interesuar ankese ne fazen e publikimit te DST. KSHA vlereson se, persa i perket kesaj pike argument i paraqitur nga OE nuk qendron.

Kompania juaj ka paraqitur formularet ESIG025 ku inxhinjeri eshte i perfshire por asnje nga keto formular nuk eshte i vertetuar nga Zyrtar Tatimore me vule dhe firme te njome ose me ane te vules elektronike te gjeneruara nga tatimet.

Per sa me siper KSHA rrezon ankimimin e OE OES Distrimed ne lidhje me kete pike

3-Ne lidhje me pretendimin 3, ne paragrafin 3, faqa 6, KSHA pasi verifikoi pretendimin tuaj, konstaton se pretendimi juaj, persa i perket kesaj pike, qendron.

4- Ne lidhje me pretendimin 4, ne paragrafin 4, faqa 6, KSHA pasi verifikoi pretendimin tuaj, konstaton se pretendimi juaj, persa i perket kesaj pike, qendron.

5- Ne lidhje me pretendimin 5, ne paragrafin 5, faqa 7, KSHA pasi verifikoi pretendimin tuaj, konstaton se pretendimi juaj, persa i perket kesaj pike ,qendron.

6- Ne lidhje me pretendimin 6, ne paragrafin 6, faqa 7, KSHA pasi verifikoi pretendimin tuaj, konstaton se pretendimi juaj, persa i perket kesaj pike, qendron.

7- Ne lidhje me pretendimin 7, ne paragrafin 7, faqa 7, KSHA pasi verifikoi pretendimin tuaj, konstaton se pretendimi juaj, persa i perket kesaj pike, qendron.

8- Ne lidhje me sqarimin e OE te dhene per pretendimin 8, ne paragrafin 8, faqa 7, KSHA shqyrtoi me kujdes dokumentacionin e paraqitur nga OE OES Distrimed dhe pasi shqyrtoi DST si dhe vleresimin e bere prej KVO vlereson se certifikata e pjesemarrjes “Technical Training” nga data 27/11/2018 deri ne date 28/11/2019 ne kursin Biochemistry Anylizer BS-240 te leshuar nga kompania Mindray nuk permbush kriterin e vendosur prej AK ne DST, pasi Certifikata e pjesemarrjes ne rastin me te mire verteton pjesemarrjen e subjektit ne aktivitetin/kursin e ofruar, por nuk jep te dhena apo informacion mbi dijet e nxena dhe aq me pak per aftesine dhe/apo kapacitetin per te ofruar sherbimin e kerkuar nga AK ne DST. Persa me siper, si dhe duke patur parasysh sherbimin tejet specifik qe kerkohet per te cilin eshte i nevojshem pasja e kualifikimit perkates KSHA vlereson se pretendimi persa i perket kesaj pike, argumentimi i paraqitur nga OE nuk qendron. Per pasoje KSHA rrezon ankimimin e OE ne lidhje me kete pike.

9-Ne lidhje me pretendimin 9, ne paragrafin 9, faqa 8 KSHA pasi shqyrtoi DST, ofertat e paraqitura, Vendimin e KSHA se pare ngritur me urdherin nr 51 date 28.05.2019 si dhe argumentimin e OE O.E.S Distrimed konstaton se ne baze te nenit 56 te VKM “Per rregullat e Prokurimit Publik“, verifikimi per ofertat anomalisht te ulet, behet vetem per ofertat e vlefshme, pra te kualifikuara. Pasi shqyrtoam argumentat vleresojme se oferta e paraqitur nga OE nuk mund te verifikohej per oferte me cmim anomalisht te ulet nga KVO, apo/dhe KSHA e pare , persa kohe, nga te dyja komisionet oferta nuk eshte kualifikuar si e vlefshme. Sa me siper, KSHA e dyte ngritur me urdherin nr 69 date 06.08.2019 nuk mund te kontatoi nese oferta juaj eshte anomalisht e ulet, pasi si nga dy vleresimet e meparshme ashtu edhe nga vleresimi yne, ku sic kemi permendur me siper, operatori ekonomik OES

Distrimed nuk permbush kriterin per tu kualifikuar. Per pasoje, duke qene se oferta juaj nuk konstatohet e vlefshme nuk mund te jete subjekt i verifikimit per cmim anomalisht te ulet.

10- Ne lidhje me sqarimin e OE, te dhene per pretendimin ne paragrafin e fundit pika 10, faqa 9, KSHA pas shqyrtimit te DST dhe argumentimin e dhene nga ana juaj qe AK ka vepruar ne menyre te njeanshme pasi te gjitha OE pjesemarres ne kete procedure prokurimi kane paraqitur certificate te se njeites directive CE pasi pajisjet laboratorike sipas Keshillit te Europes klasifikohen ne direktiven IVDD 98/79/EC KSHA konstatoi qe certifikatat e paraqitura nga te gjitha OE jane ne perputhje me direktivat 98/79/EC te Keshillit te Europes per paisjet laboratorike.

Ne baze te konstatimeve te siperpermdura, KSHA le ne fuqi vendimin e skualifikimit te Operatorit Ekonomik O.E.S Distrimed Shpk.

II.10.2. Në datën 22.08.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar skualifikim e tij nga procedura e mësipërme e prokurimit. Gjithashtu ngrihen pretendime për shoqërinë “Biomedica Albania Distribution” sh.p.k, si edhe në autoritetin kontraktor.

II.11. Në datën 03.09.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publi me nr. 1420/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 822 prot., datë 03.09.2019, bashkëngjitur informacioni dhe dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesave të mësipërme.

II.12. Në datën 13.09.2019 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin KPP 606/2019, ku vendosi si më poshtë:

- 1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “O.E.S. Distrimed” sh.p.k, për procedurën e prokurimit me Nr.REF-17552-04-11-2019, me objekt: “Blerje Autonalizator Biokimik”, me fond limit 3 000 000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 16.05.2019 nga autoriteti kontraktor Qendra Shendetësore e Specialiteteve nr. 1.*
- 2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k për procedurën e prokurimit*
- 3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “O.E.S. Distrimed” sh.p.k, duke e kualifikuar atë.*
- 4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “O.E.S. Distrimed” shpk.*
- 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.*
- 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

II.13. Në datën 24.09.2019 operatori ekonomik “Biomedika Albania Distribution” sh.p.k është vënë në dijeni elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë vijon:

1. "O.E.S. Distrimed" sh.p.k	1.298.750 lekë, kualifikuar
2. "Fedos" sh.p.k	1.570.000 lekë, skualifikuar
3. "Genius" sh.p.k	1.980.000 lekë, skualifikuar
4. "Farma Net Albania" sh.p.k	2.850.000 lekë, skualifikuar
5. "Biomedica Albania Distribution" sh.p.k	2.935.000 lekë, kualifikuar
6. "Krijon" sh.p.k	ska paraqitur ofertë

II.14. Në datën 24.09.2019 operatori ekonomik "Biomedika Albania Distribution" sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e shoqërisë "O.E.S Distrimed" sh.p.k. Konkretisht pretendohet si më poshtë:

Duke qene se jemi rivendosur ne afate me rivleresimin e ri te Autoritetit, ashtu sic u vendos dhe kompania O.E.S Distrimed me vendimin e meparshem te KPP 476/2019 te dates 22.07.2019, duke qene se ka disa pika qe ne i kemi ankimuar sipas afateve ligjore ne AK por nuk jane shqyrtuar me perpara (Oferta Anomialisht e ulet, VKM Nr. 495 mbi format e dokumentave elektronike, vendimet e dyzuara te AK etj) dhe duke qene se disa argumenta te sjella mund te sherbejne per rivlersim te kualifikimit, permiresimin dhe saktesimin e disa praktikave aktuale, besojme se pretendimet tona kane baze ligjore dhe kjo ceshtje e pretenduar e pa ezauruar nuk merr cilesine e nje ceshtjeje te shqyrtuar tashme nga KPP, dhe nuk zbatohet parimi i gjese se gjykuar dhe per rrjedhim, pretendimet tona mund te merren ne shqyrtim nga Autoriteti.

Ne lidhje me kompanine O.E.S Distrimed shpk, te rikualifikuar, deshirojme qe te sjellim disa fakte te cilat ne i kemi kemi ankimuar prane jush eshte dhene e drejta nga KSHA dhe me pas pasi ceshtja eshte rrikthyer dhe rivleresuar per te disaten here.

Fakti nr 1:

Ne baze te konstatimit mbi cmimin e ofruar kjo kompani ka bere nje oferte ekonomike anomalisht te ulet.

Dy here na eshte dhene e drejta qe oferta eshte anomalisht e ulet dhe me rivendosjen ne afate te ankimit nuk eshte trajtuar si pike me argumentin e mos kualifikimit te ofertes, nderkohe qe subjekti O.E.S Distrimed ka vazhduar i skualifikuar. Ne kete menyre gjendja faktike e juridike e operatorit O.E.S DISTRIMED nuk ndryshoi, dhe mbetet i skualifikuar nga procedura e prokurimit ne fjale, nderkohe qe kompania jone ka qene e kualifikuar dhe fituese, cka nuk mund te legjitimonte ankimin tone te metejshem. Tashme sipas klasifikimit te ri gjendja faktike juridike e operatorit O.E.S DISTRIMED ndryshoi dhe kompania eshte kualifikuar. Per rrjedhoje ne ankojme se:

Ose procedura dhe vleresimi nuk eshte bere sic duhet nga Autoriteti Kontraktor ose O.E.S Distrimed SHPK duhet te skualifikohet per anomalishte ulet. Pra si oferte e kualifikuar tashme eshte apo nuk eshte oferte anomalishte ulet ajo e paraqitur nga O.E.S Distrimed???

Ne baze dhe te argumentave te paraqitura nga kompania OES Distrimed dhe te bera transparente tashme, nuk permbushen kushtet kumulative te kerkuar nga ligji i posacem ne drejtim te ofertes ekonomike anomalisht te ulet.

a- Nuk ka fatura te produktit te ofruar dhe te blere me perpara qe te mbeshtesi cmimin e ofruar. Institucioni juaj do jete eksperimenti i pare ne kete drejtim.

b- Nuk eshte prezantuar asnje kosto ne lidhje me garancine dhe mirembajtjen 3 vjecare.

c- Nuk ka dhene asnje kosto per inxhinjerat e tyre qe do mirembajne pajisjen per 3 vite ne garanci dhe presupozohen te jene trajnuar por qe ne e kemi permendur disa here qe nuk jane dhe kane thjesht certifikata pjesemarrje. A kane kosto?

Kur institucioni ka tenderuar 3,000,000 lek, te ofrohet ne vleren 1,298,750 leke, ku perfshihen reagente dhe mirmbajtja 3 vjecare, eshte jashte llogjikes se tregut. Ose pajisja e ofruar eshte karton Kinez ose Instucioni juaj ka keqplanifikuar gjithshka dhe nuk ka respektuar proceduren.

Mireperdorimi i fondeve publike perfshin jo vetem perzgjedhjen nga autoriteti kontraktor te ofertave me te uleta (si kriter i perzgjedhjes se ofertes fituese referuar "cmimit mete ulet"), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe deshtimin e kontrates qe mund te vijne nga oferta te cilesuar si anomalisht te uleta, referuar formules se perllogaritjes te parashikuar ne ligj.

Fakti nr 2:

Kompania O.E.S Distrimed shpk nuk ka inxhinjerin te trajnuar per pajisjet objekt i kesaj kontrate ne baze te kerkesave te pikes 7.3. Kompania te kete staf te trajnuar per pajisjen, i cili eshte objekt prokurimi, te shoqeruar me certifikate.

Kompania O.E.S Distrimed ka paraqitur certifikata pjesemarrje.

a- Certifikata e pjesemarrjes eshte certifikate qe ke qene prezent ne prezantim te pajisjes por kurrsesi nuk eshte certifikate trajnimit. (Pjesemarrja ne kurse trajnimit per gjuhe te huaj nuk te ben ta kesh gjuhen e huaj te mbrojtur dhe certifikuar).

b- Certifikate e trajnimit perfshin jo vetem prezantimin e pajisjes, njohuri mbi supportin dhe mirembajtjen por shoqerohet nga nje provim perfundimtar qe certifikon njohurite e mara.

c- Pajisja eshte me origjine kineze, pa prezence te tregun shqiptare dhe ne baze te gjithë indikatorëve ne jemi te sigurve qe Inxhinjeri nuk ka marre certifikate trajnimit. Sasia e certifikatave per pajisje te tjera nuk eshte reference qe te konfirmoje cilesine dhe njohurine per pajisjen e tenderuar.

A mund te rivleresoni keto certifikime ne baze te nje dallimi te qarte midis certifikatave te pjesemarrjes dhe ato te trajnimit dhe te dilni me nje qendrim?

Fakti nr 3:

Ne DST kerkohet: Kopje te vertetuar nga Organet Tatimore te List Pageses se Sigurimeve Shoqerore, te gjeneruar nga sistemi elektronike i tatimeve, sipas formularit ESIG025, ku te perfshihen dhe emri i Inxhinierit, per periudhen Shkurt 2018- Shkurt 2019.

1- Kompania O.E.S Distrimed nuk ka paraqite formularin ESIG025 te vertetuar nga Organet Tatimore.

Ne vendimin e fundit te KPP, jane permendur

Cdo tatimpagues eshte i detyruar te beje dorezimin e deklaratave dhe dokumenteve tatimore, te parashikuara ne shkronjat "a" dhe "b", te pikes 1, te ketij vendimi, vetem nepermjet formes elektronike, duke filluar nga data 1 janar 2015.

Po eshte e vertet qe cdo subjekt duhet te beje dorezimin e deklaratave dhe dokumenteve tatimore vetem nepermjet formes elektronike, por keto jane autodeklarata per qellim tatimore dhe financiare dhe kurrsesi nuk mund te marrin formen e vertetimit nga Organet Tatimore.

A e konfirmon institucioni juaj qe kompania OES Distrimed ka paraqitur dokumentin elektronik sipas PERMBAJTJA DHE VLEFSHMERIA E DOKUMENTAVE ADMINISTRATIVE ELEKTRONIKE dhe nese jo a mund te skualifikohet edhe njehere kompania OES Distrimed nen keta indikatorë?"

II.15. NËPËRMJET SHKRESËS NR. 906 PROT., DATË 03.10.2019 AUTORITETI KONTRAKTOR I KA KTHYER PËRGJIGJE ANKIMUESIT SI VIJON:

Pasi u mor ne shqyrtim ankimi i operatorit ekonomik Biomedica Albania Distribution Shpk e cila mban daten 27.09.2019 (protokolluar nga ana jone me nr. 8989 prot, dt. 27.09.2019), ju bejme me dije si me poshte:

Ne pergjigje te pretendimeve tuaja ju sqarojme se Komisioni i Prokurimit Publik ka dale tashme me nje Vendim nr. 606/2019 date 13.09.2019, e cila ka mare ne shqyrtim ankimimet e operatoreve ekonomik ofertues te procedures se prokurimit me objekt " Blerje Autonalizator Biokimik", perfshire ketu dhe pretendimet tuaja si pale e interesuar.

1. Referuar pretendimit te Biomedica Albania Distribution Shpk se kompania OES Distrimed Shpk ka nje oferte ekonomike anomalisht te ulet;

Referuar kerkeses se Autoritetit Kontraktor per sqarime mbi ofertes ekonomike anomalisht e ulet, operatori ekonomik OES Distrimed shpk ka argumentuar rreth kesaj.

KSHA ka shqyrtuar dhe argumentet e tyre ne lidhje me oferten per tenderin me objekt Blerje Autoanalizator Biokimik.

Informacioni i paraqitur nga operatori ekonomik OES Distrimed Shpk e bindi KSHA-ne qe pajisja me objek Autonalizator Biokimik mund ti plotesoje nevojat e institucionit tone.

Ky operator e ka dhene te detajuar te gjithe vleren e ofertes qe nga cmimi i dhene nga prodhuesi e deri ne realizimin final te saj.

2. Ne lidhje me pretendimin e Biomedic Albania Distribution Shpk se kompania OES Distrimed Shpk nuk ka inxhinierin te trajnuar per pajisjet objekt i kesaj kontrate ne baze te pikes 7.3 »Kompania te kete te trajnuar per pajisjen i cili eshte objekt prokurimi, te shoqeruar me certificate«, referuar vendimit te KPP-se nr. 606/2019, date 13.09.2019, veren se operatori ekonomik OES Distrimed shpk ka paraqitur certificate pjesmarrje ne emer te Z. A. Prendi ne kursin e Autonalizator Biokimik BS-240 Trajnim Teknik nga dt. 27.11.2018 - 28.11.2018, nenshkruar nga Departamenti i Trajnimeve te Kompanise Shenzhen Mindray Bio-medical Electronic Co., Ltd, e vlefshme per dy vjet. Gjithashtu per zotin A. Prendi eshte paraqitur kontrata e punes e lidhur me OES Distrimed Shpk si punedhenes me dt.03.01.2019 me afat nje vjecar; CV, Diploma si dhe figuron ne listepagesat e shoqerise per periudhen e kerkuar, ku rezulton i punesuar. Per sa me siper ne mbeshtetje te nenit 46 pika l germa «b» te ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 «Per prokurimin publik», i ndryshuar, ne mbeshtetje te nenit 53/3 te LPP dhe nenit 66 pika 3 te VKM-se nr. 914, dt.29.12.2014, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave gjykon se operatori ekonomik OES Distrimed shpk ploteson kerkesen e autoritetit kontraktor per certificate trajnimi ku te perfshihen pajisjet e ofertuara ne kete procedure prokurimi te perkthyer dhe te noterizuara, pasi kjo shoqeri ka paraqitur certificate ne emer te inxhinierit Z.A. Prendi ne kursin e Autonalizator Biokimik BS-240 Trajnim Teknik nga dt. 27.11.2018 - 28.11.2018, nenshkruar nga Departamenti i Trajnimeve te Kompanise Shenzhen Mindray Bio-medical Electronic Co., Ltd, e vlefshme per dy vjet.

3. Ne lidhje me pretendimin e Biomedic Albania Distribution Shpk se kompania OES Distrimed Shpk nuk ka paraqitur formularin ESIG 025, te vertetuar nga Organet Tatimore.

Referuar vendimit te KPP-se nr. 606/2019 date. 13.09.2019, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se operatori ekonomik OES Distrimed shpk ne permbushje te kriterit per listepagesat ka dorezuar dokumentacionin si me poshte:

Listepagesat per periudhen Shkurt 2018 - Shkurt 2019 te gjeneruara nga sistemi online i Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve.

Ne VKM nr. 922, dt. 29.12.2014 "Per deklarimin e detyrueshem e deklaratave tatimore dhe dokumentave te tjera tatimore, vetem nepermjet formes elektronike" neni 1, pika "xii" parashikon se: "Dorezimin e detyrueshem, vetem nepermjet formes elektronike, te deklaratave tatimore dhe te dokumentave te tjera tatimore, objekt i ketij vendimi me te cilat nenkuptohen: xii)deklarata "Listepagese e kontributeve te sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe tatimi mbi te ardhurat nga punesimi".

Gjithashtu ne nenin 2 te VKM 922/2014 parashikohet se "Cdo tatimpagues eshte i detyruar te beje dorezimin e deklaratave dhe dokumentave tatimore te parashikuara ne shkronjat "a" "b", te pikes 1, te ketij vendimi vetem nepermjet formes elektronike, duke filluar nga dt. 1 Janar 2015, sipas afateve ligjore te percaktuara dhe formes se deklarates apo te dokumentit te miratuar me udhezim te Ministrit te Financave".

Pra, referuar dispozites ligjore te sipercituar, deklarimi i listepagesave E-sig 025 kryhet vetem ne menyre elektronike.

Komisioni gjykon se operatori ekonomik ka paraqitur listepagesat te gjeneruara nga sistemi online i Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, duke permbushur keshtu kerkesen e autoritetit kontraktor. Pra, ne baze te Vendimit te Komisionit te Prokurimit Publik me nr. 606/2019 date 13.09.2019 eshte vendosur kualifikimi i operatorit ekonomik O.E.S Distrimed shpk."

II.16. Në datën 07.10.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.17. Në datën 17.10.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1581/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 746 prot., datë 17.10.2019, bashkëgjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Biomedica Albania Distribution" sh.p.k se: *O.E.S Distrimed SHPK duhet te skualifikohet per ofertë anomalishte ulet. Ne baze dhe te argumentave te paraqitura nga kompania OES Distrimed dhe te bera transparente tashme, nuk permbushen kushtet kumulative te kerkuar nga ligji i posacem ne drejtim te argumentimit te ofertes ekonomike anomalisht te ulet.*

a- Nuk ka fatura te produktit te ofruar dhe te blere me perpara qe te mbeshtesi cmimin e ofruar. Institucioni juaj do jete eksperimenti i pare ne kete drejtim.

b- Nuk është prezantuar asnjë kosto në lidhje me garancinë dhe mirëmbajtjen 3 vjeçare.

c- Nuk ka dhënë asnjë kosto për inxhinjerat e tyre që do mirëmbajnë pajisjen për 3 vite në garanci dhe presupozohen të jenë trajnuar por që në këmbë përmendur disa here që nuk janë dhe kanë thjesht certifikata pjesëmarrje. A kanë kosto? Kur institucioni ka tenderuar 3,000,000 lek, të ofrohet në vlerën 1,298,750 leke, ku përfshihen reagente dhe mirëmbajtja 3 vjeçare, është jashtë logjikës së tregut. Ose pajisja e ofruar është karton Kinez ose Institucioni juaj ka keqplanifikuar gjithshka dhe nuk ka respektuar procedurën. Mirëperdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave me të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar "cmimit me të ulët"), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe deshtimin e kontratës që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formules së perlllogaritjes të parashikuar në ligj", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Sipas përgjigjes së autoritetit kontraktor, dhënë ankimuesit nëpërmjet shkresës nr. 906 prot., datë 03.10.2019 është sqaruar se:

“Referuar pretendimit të Biomedica Albania Distribution Shpk se kompania OES Distrimed Shpk ka një ofertë ekonomike anomalisht të ulët; Referuar kërkesës së Autoritetit Kontraktor për sqarime mbi ofertën ekonomike anomalisht të ulët, operatori ekonomik OES Distrimed shpk ka argumentuar rreth kësaj. KSHA ka shqyrtuar dhe argumentet e tij në lidhje me ofertën për tenderin me objekt Blerje Autoanalizator Biokimik. Informacioni i paraqitur nga operatori ekonomik OES Distrimed Shpk e bindi KSHA-në që pajisja me objekt Autoanalizator Biokimik mund të plotësojë nevojat e institucionit të tij. Ky operator e ka dhënë të detajuar të gjithë vlerën e ofertës që nga cmimi i dhënë nga prodhuesi e deri në realizimin final të saj.”

III.1.2. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si vijon:

Shtojca 10

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet Teknike:

1. Autoanalizator Biokimik

1.1 Autoanalizatori duhet të kryejë jo më pak se 200 teste/ore.

1.2. Pajisja duhet të disponojë me shpejtesi jo më të vogël se 380 teste/ ore, me modul ISE modul Na, K, Cl.

1.3. Pajisja duhet të ketë rreth jo më pak se 50 pozicione për reagentet (40 prej të cilëve të jenë të fiksuara).

1.4 Te ketë panele analizash si: Renal, Diabeti, Kardiak, Pankreas, Lipide, Imune, Rmatizem, Inorganike, dhe Anemi, Hepatike etj.

2. Reagentet

2.1. Pajisja të shoqërohet Reagente për 5000 analiza dhe duhet të supëtojë reagentet e mëposhtme.

Nr	Reagente	Metoda	njesia
1	Glucose	GOD-POD	ml
2	Cholesterol	CHOD-PAP	ml
3	Trglycerides	GPO-PAP	ml
4	Urea UV	Kinetic-Urease	ml
5	ALT (SGPT)	IFCC	ml
6	AST (SGOT)	IFCC	ml
7	Bilirubine Totale	Colorimetric	ml
8	Bilirubine Directe	Colorimetric	ml
9	Creatinine	Jaffe ëithout deproteinization	ml
10	Alkaline Phosphatase (ALP)	IFCC	ml
11	GGT	Carboxy substrate	ml
12	Iron	Ferrozine	ml
13	Acid Uric	Uricase POD	ml
14	Calcium	CCP	ml
15	Alpha Amylase	Kinetic	ml
16	Tromboplastine Calcike		ml
17	ASO	Aglutinim	tests
18	CRP	Aglutinim	tests
19	FR	Aglutinim	tests
20	Serum kontrolli normal (Human Assayed Controll)	1X 5 ml	Shishe
21	Proteine totale	Biuret	ml

Reagentet te jene te shoqeruara me manualin perkates dhe me skadence jo me pak se 1 Vit nga momenti i dorezimit. Nese kane afat me te shkurter skadimimi ateherë operatori ekonomik duhet ti terheqe reagentet qe jane afer dates se skadimit dhe te sjelle te tjera me afat me te gjate.

2.2. Mundesi te cdo tipi shishe: te mesme ose te vogla, dedektimi i nivelit te lengut

2.3. Te realizoje ftohje 24 ore (non-stop) te perhershme per diskun e reagenteve ne temperature 2 – 12^o C.

2.4. Te mundesoje vellim te ulet reaksioni duke filluar nga 100 µl.

2.5 Leximi i absorbances te filloje nga 0.0

3. Mostrat

3.1. Disku te mbaje jo me pak se 50 tuba analizash.

3.2. Kyveta te cilesise se larte me diameter optic jo me pak 5 mm.

3.3. Proces automatic per larje te vazhdueshme te pipetave.

4. Softëare

4.1. Sistem i hapur me funksion prioritar STAT.

4.2. Rregjistrim te pacienteve.

4.3. Lidhje te sistemit me PC dhe printer te jashtem.

4.4. Metoda e analizës: end-point, kinetike, Fixed-time, monokromatike/biokromatike, reagent kimike single/dual, turbidimetri, Teknologji zgjedhese te electrodes se joneve, fotometri absorbuese.

4.5. Kalibrim linear dhe jo linear.

5. Grupi Optik

5.1. Llampe halogjene

5.2 Jo me pak se 8 filtra optike te brendshme (340, 405, 450, 510, 546, 578, 630, 670 nm).

5.3. Te kete 40 Kyveta shumeperdorimshe.

5.4. Larje automatike e Kyvetave.

5.5. Konsum uji jo me shume se 4 L/ore ($< = 4$ L/ore).

6. Te shoqerohet me:

6.1. Printer te jashtem

6.2. Reagente per 5000 analiza.

6.3. Me te gjithë aksesoret e tjere te cilet jane te nevojshme per ta vendosur ne gjendje te plote pune.

6.4. Te jete i pajisur me Certifikate CE.

6.5. Prodhim i dy viteve te fundit (2017-2018).

6.6. Garancia te pakten 3 vjet.

6.7. Manuallet e perdorimit dhe te servisimit.

7. Specifikime te pergjitheshme:

7.1. Kompania te kete te pakten nje inxhinier te certifikuar per pajisje mjekesore.

7.2. Kompania te jete e autorizuar nga Ministria e Shendetesise per tregtim te pajisjeve mjekesore.

7.3. Kompania te kete staf te trajnuar per pajisjen i cili eshte objekt prokurimi te shoqeruar me certifikate.

7.4. Koha e levrimit te pajisjes 30 dite nga moment i nenshkrimit te kontrates.

III.1.3. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.1.4. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni I vlerësimit

të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP [...]”.

III.1.5. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangijen e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përllogaritjes të parashikuar në ligj”.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi ofertën ekonomike të operatorit ekonomik “OES Distrimed” sh.p.k., dhe nga përlllogaritjet e kryera, referuar bazës ligjore si më sipër cituar, rezulton se oferta e operatorit ekonomik “OES Distrimed” sh.p.k., është anomalisht e ulët dhe sipas informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton se ky fakt është konstatuar edhe nga KVO-ja. Për këtë arsye KVO-ja i ka kërkuar operatorit ekonomik “OES Distrimed” sh.p.k., të paraqesë me shkrim dhe në mënyrë elektronike në sistemin e prokurimeve elektronike shpjegime për elementë të vecantë të ofertës për: anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; origjinalitetin e punëve, mallrave apo shërbimeve të propozuara nga ofertuesi si dhe zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna shërbimi apo do të sigurohet furnizimi.

Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton se nga ana e operatorit ekonomik “OES Distrimed” sh.p.k., me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, është dorëzuar dokumenti datë 31.05.2019 me objekt: “Agumentim oferte” i cili përmban analizën e detajuar të ofertës ekonomike, bashkëngjitur oferta dhe komunikimi përkatës nga prodhuesi i pajisjes, kompania “Mindray”. Sipas kësaj shkrese, operatori ekonomik “OES Distrimed” sh.p.k ka argumentuar si vijon:

“Lidhur me kërkesën tuaj për argumentimin e ofertës së paraqitur nga “OES Distrimed” sh.p.k për tenderin me objekt: “Blerje autoanalizator biokimik”, në zbatim të kërkesave të nenit nr.56 të LPP dhe të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, ju sqarojmë si më poshtë:

- *Oferta e dhënë nga OES Distrimed shpk për tenderin me objekt: “Blerje autoanalizator biokimik”, me vlerë 1.298.750 lekë pa tvsh është reale dhe e realizueshme.*
- *Firma jonë ka aplikuar fitim optimal duke patur parasysh edhe vo;umin e madh që kryejmë në shitjen e pajisjeve mjekësore dhe laboratorike.*
- *Duke qënë se kemi një bashkëpunim prej më shumë se 10 vite, firma prodhuese “Mindray” na ka dhënë cmim special për këtë tender.*
- *Më poshtë analiza e detajuar e ofertës sonë ekonomike, bashkëngjitur gjithashtu oferta dhe komunikimet përkatëse nga prodhuesi i pajisjes:*

Nr.	Emërtimi	Prodhuesi	Vlera (USD)	Kursi Këmbimit	Vlera (lek)
1	Cmimi blerjes pajisjes	Mindray	7800	110 lekë	858.000
2	Reagente për 5000 analiza	Mindray	500	110 lekë	55.000
3	Transporti ndërkombëtar me ajër + shpenzime të tjera (transferta bankare, shpenzime doganore, regjistrim, transport local, instalim etj.)	Skynet	1300	110 lekë	143.000
4	Fitimi				242.750
5	Oferta				1.298.750

OES Distrimed shpk deklaron se nëse shpallet fitues do të realizojë kontratën në kohë dhe me produkte cilësore, konform kërkesave të DST-së.”

III.1.7. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim argumentimet e ofertës ekonomike, të paraqitura nga shoqëria “OES Distrimed” sh.p.k. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezultoi se, me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nga ana e operatorit ekonomik “OES Distrimed” sh.p.k., është dorëzuar dokumenti “Agumentim oferte” me analizën e detajuar të ofertës ekonomike, ku është argumentuar në lidhje me ofertën e tij, shoqëruar edhe email-in e prodhuesit “Mindray” të pajisjes. Nga verifikimi i kryer rezultoi se nuk është paraqitur asnjë dokument apo komunikim përsa i përket vlerës së ofruar për zërin “*Transporti ndërkombëtar me ajër + shpenzime të tjera (transferta bankare, shpenzime doganore, regjistrim, transport local, instalim etj.)*”, e cila rezultoi në një vlerë të konsiderueshme, mbi 10% të shpenzimeve për këtë pajisje të ofruar. Gjithashtu për zërin “*Reagentë për 5000 analiza*”, që përfshihet në ofertë me numër rendor 2, çmimi i ofruar në tender nga shoqëria OES Distrimed shpk për 500\$, rezultoi më i vogël se oferta e dhënë nga shoqëria prodhuese Mindray prej 800\$. Nga ana e shoqërisë OES Distrimed sh.p.k nuk rezultoi të jetë dhënë asnjë sqarim më i detajuar për këtë zë ndaj dhe diferenca ndërmjet çmimit të ofertuar dhe çmimit kosto për njësi është me vlerë negative, ç’ka do të thotë që operatori ekonomik “ OES Distrimed” sh.p.k., nuk garanton autoritetin kontraktor se mund të marrë përsipër realizimin me sukses të kontratës së furnizimit. KPP riktheson se, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, i cili duhet të jap analiza sa më të sakta dhe të shoqëruara me dokumenta provuese për të bindur autoritetin kontraktor. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo bindës që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Biomedica Albania Distribution” sh.p.k. qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Biomedica Albania Distribution” sh.p.k., për kualifikimin e padrejtë të shoqërisë “OES Distrimed” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur intereset e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Biomedica Albania Distribution” sh.p.k, për procedurën e prokurimit me Nr.REF-17552-04-11-2019, me objekt: “*Blerje Autonalizator Biokimik*”, me fond limit 3 000 000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 16.05.2019 nga autoriteti kontraktor Qendra Shendetësore e Specialiteteve nr. 1.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “O.E.S. Distrimed” sh.p.k, duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vëre në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Biomedica Albania Distribution” shpk.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1581 Protokolli,

Datë 07.10.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha